

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5674  
E shtunë, 12 janar 2019  
çmimi 0.40 €

## Haradinaj: Përfshirja e LDK-së dhe e LV-së do ta fuqizonte Kosovën në dialog



FAQE 3

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE

#### Ç'DONI JU, SHOIPTARËT E SERBIZUAR DHE TË KOSOVARIZUAR?!

F. 10



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

#### MUSTAFA: DISPONIMI I LDK-SË ËSHTË TË RRËZOHET KJO QEVERI

F. 6

#### LIMAJ NË PRIZREN PREZANTON ADERIMET E REJA TË NISMËS

F. 6

### EKONOMI

#### ÇMIMET E KONSUMIT SHËNUAN NGRITJE 2.9 PËR QIND

F. 9

#### MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL, SESION INFORMATIV RRETH GRANTEVE

F. 9

### KULTURË

#### 'BARDHËSITË E ATDHEUT', LIBRI MË UNIVERSAL, GJITHËPËRFSHIRËS DHE MË I KOMPLETUAR PËR HERONJTË...

F. 13



### SPORT

#### KB RAHOVECI, ORGANIZATOR I 'FINAL 8' TË KUPËS SË KOSOVËS

F. 20



FLET PËR "EPOKËN E RE", MIMOZA KUSARI-LILA | FAQE 4-5

## Ekipi për dialog s'ka peshë unifikuuese dhe negociuuese

Kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila, ka vlerësuar se dialogu me Serbinë është në kaos total për shkak të kërkesës së BE-së për heqjen e taksës dhe insistimit të Kosovës për ta mbajtur taksën deri në njohjen nga Serbia. Në këtë intervistë dhënë për

gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se mosinkuadrimi i dy partive më të mëdha në dialog ka bërë që ekipi negociator mos ta ketë peshën unifikuuese dhe negociuuese. Deputetja Kusari-Lila ka deklaruar se nuk do të mund të ketë vazhdim të dialogut në

këto rrethana dhe me këtë përbërje të ekipit negociator. Sipas saj, zgjidhje për situatën e krijuar në Kosovë dhe për kaosin institucional janë zgjedhjet e jashtëzakonshme për kohën e organizimit të të cilave duhen marrë vesh partitë mes vete

## 16 institucione qendrore paguajnë qira

Ministri i Ministrisë së Administratës Publike, Mahir Jaghillar, ka bërë me dije të premtën se aktualisht në hapësira me qira funksionojnë 16 institucione qendrore me 1 211 zyrtarë. Teksa e ka informuar kabinetin qeveritar për gjendjen e akomodimit të institucioneve, ai ka kërkuar nga kabinetin qeveritar që të zgjidhet kjo problematikë. Qeveria i ka rekomanduar Ministrisë së Administratës Publike ta përfundojë analizën e kostove buxhetore për të gjitha opsionet e rekomanduara për zgjidhjen e kësaj çështje | FAQE 3



## Kërcënimet me greva

Greva po bëhet gjithnjë e më tepër si forma më e preferuar e punonjësve në sektorë të caktuar publikë për shtimin e presionit ndaj Qeverisë për rritje të pagave dhe për kushte më të mira të punës | FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Këshilli i Ambasadorëve i bën thirrje Ramës ra rivlerësojë kandidaturën e Cakajt!

Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë thotë se kryeministri nuk ka kryer detyrimin e tij kushtetues për të bërë transparencën mbi arsyet që e kanë shtyrë atë të shkarkojë posaçërisht ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme

**TIRANË, 11 JANAR** - Pas debatit që shkaktoi mosdekretimin nga presidenti Ilir Meta i Gent Cakajt në postin e ministrit të Jashtëm, ka ardhur reagimi nga Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë.

Ky këshill tërheq vëmendjen pasi, sipas tij, kryeministri nuk ka kryer detyrimin e tij kushtetues për të bërë transparencën mbi arsyet që e kanë shtyrë atë të shkarkojë posaçërisht ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme.

"Kohët e fundit kryeministri i Shqipërisë ka ndërmarrë disa ndryshime të rëndësishme në qeverinë që ai drejton, përfshirë këtu edhe shkarkimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati dhe propozimin për në këtë post të zëvendësimit aktual, Gent Caka. Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë vlerëson se është krejtësisht në të drejtën politike dhe kushtetuese të kryeministrit të bëjë ndryshime në qeveri, në përputhje me vlerësimet që ai ka lidhur me arritjet apo dobësitë e njërit apo tjetrit nga ministrat. Por Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë tërheq vëmendjen me shqetësim te fakti se kryeministri nuk ka kryer detyrimin e tij kushtetues për të bërë transparencën mbi arsyet që e kanë shtyrë atë të shkarkojë posaçërisht ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme. Nevoja për një transparencë të tillë buron nga roli specifik që ka institucioni i ministrit të Jashtëm në përbushjen e objektivave strategjike

të shtetit shqiptar në këtë periudhë", thuhet në reagimin e ambasadorëve shqiptarë.

Këshilli thotë se viti 2019 do të jetë veçanërisht i ngarkuar me sfida për diplomacinë tonë dhe në përgjithësi për politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë.

"Më kryesoret e këtyre sfidave janë marrja e vendimit për çeljen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian nga ana e Këshillit Evropian në fund të pranverës së ardhshme, përfundimi i shtyrë te çdo parashikimi i marrëveshjes për kufirin detar me Greqinë, përgatitje intensive, nëpërmjet ngritjes së infrastrukturës së përshtatshme për marrjen e presidencës së OKB-së në vitin 2020, ndërtimi i një mirëbesimi të gjerë ndërkombëtar për të fituar të drejtën e anëtarit të përkohshëm në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për vitin 2022, gjë që kalon përmes një votimi në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së. Përballimi i këtyre sfidave disa nga të cilat janë thellësisht të reja për politikën, diplomacinë dhe administratën e shtetit tonë, do të duhet të bëhet krahas kryerjes së detyrave të tjera dinamike që shtrihen në zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, për ta forcuar rolin e Shqipërisë në mbështetje të paqes e të stabilitetit në rajon e në botë, duke e vënë njëherësh politikën e jashtme më mirë në shërbim të një poli-



tike të brendshme zhvillimore, në përgjigje të aspiratave të shoqërisë shqiptare për rritje të mirëqenies, thellim të demokracisë dhe konsolidim të

shtetit të së drejtës, thuhet tutje në reagimin e Këshillit të Ambasadorëve Shqiptarë. Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë vëren se kandidatura

e përzgjedhur nga kryeministri Rama për të emëruar ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Gent Cakaj, ka ngjallur një shqetësim të madh në një pjesë të gjerë të opinionit publik, përfshirë edhe shumicën e anëtarëve të këtij Këshilli.

"Ky lloj kontestimi, i pashembullt për asnjë nga ministrat e jashtëm të Republikës së Shqipërisë gjatë këtyre 29 vjetëve demokraci, mbështetet në perceptimin publik të personalitetit të Cakajt si pa cilësi të nevojshme profesionale për të mbajtur barrën e një detyre të tillë me rëndësi kombëtare. Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë i tërheq vëmendjen kryeministrit Rama ta rivlerësojë kandidaturën e ministrit në fjalë, duke mbajtur më mirë parasysh interesin publik dhe kombëtar", thuhet në fund të reagimit të Këshillit të Ambasadorëve Shqiptarë.

## Opozita kërkon komision hetimor për rastin Cakaj

**TIRANË, 11 JANAR** - Opozita ka dorëzuar të premten në Kuvend kërkesën për ngritjen e një komisioni hetimor për të verifikuar nëse DSIK e ka zbatuar Ligjin për pajisjen e zëvendësministrit të Jashtëm Gent Cakaj me certifikatë sigurie dhe si është zbatuar Ligji për administrimin dhe përpunimin e informacioneve pa qenë i pajisur më parë me

këtë dokument. Në kërkesën e opozitës janë 4 çështje që janë objekt i hetimit parlamentar. Në dokumentin e opozitës, kërkohet që një nga personat që do të hetohet nga parlamenti të jetë kryeministri Edi Rama për rolin e tij, sipas opozitës, në shkeljen e rregullave për garantimin e sekretit shtetëror.

## Kuvendi miraton ndryshimet kushtetuese, Maqedonisë i ndryshohet emri

**SHKUP, 11 JANAR** - Kuvendi i Maqedonisë ka votuar me 81 vota pro, në seancën plenare të së premtes, të programuar fillimisht për një ditë më parë, por të shtyrë për këtë të premte, të katër amendamentet kushtetuese që i hapin rrugë ndryshimit të emrit në Republika e Maqedonisë së Veriut, sipas marrëveshjes së Prespës. Me këtë votim ka mbaruar zyrtarisht procesi për ndryshimet kushtetuese të këtij vendi, ndërsa marrëveshja e Prespës do t'i kalojë tashmë Parlamentit grek për t'u ratifikuar edhe atje në mënyrë që gjithçka të konsiderohet e përfun-

duar.

Ndryshimet kushtetuese janë miratuar pas negociatave të gjata me opozitën shqiptare lidhur me disa amendamente të saj për pozitën e shqiptarëve në kushtetutën. Marrëveshja parashikon që me ligj të rregullohet edhe çështja e letënjohimit me çka do të shtohet një grafi e përkatësisë etnike. Për kujdesin ndaj diasporës pranohet amendamenti i lëvizjes Besa që të përmenden të gjitha bashkësitë etnike të pranuar me Kushtetutë.

Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev vendimin e Kuvendit e ka

vlerësuar si shumë të rëndësishëm për të ardhmen vendit, pasi me këtë mbyllet kontesti 27-vjeçar me Greqinë për çështjen e emrit, që ka mbajtur për aq kohë të bllokuar edhe anëtarësimin e Maqedonisë në NATO dhe Bashkimin Evropian. Kontesti mes dy vendeve daton që nga viti 1991, kur Maqedonia kishte shpallur pavarësinë, ndërsa Greqia kishte bllokuar integrimin e saj në NATO dhe BE, me arsyetimin se fqinji i saj mund të ketë pretendime ndaj territorit të saj verior që, po ashtu, quhet Maqedoni.



Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

# 16 institucione qendrore paguajnë qira

Ministri i Ministrisë së Administratës Publike, Mahir Jaghillar, ka bërë me dije të premtën se aktualisht në hapësira me qira funksionojnë 16 institucione qendrore me 1 211 zyrtarë. Teksa e ka informuar kabinetin qeveritar për gjendjen e akomodimit të institucioneve, ai ka kërkuar nga kabineti qeveritar që të zgjidhet kjo problematikë. Qeveria i ka rekomanduar Ministrisë së Administratës Publike ta përfundojë analizën e kostove buxhetore për të gjitha opsionet e rekomanduara për zgjidhjen e kësaj çështje

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 11 JANAR** - Ministria e Administratës Publike ka njoftuar të premtën Qeverinë e Kosovës për gjendjen aktuale të akomodimit të institucioneve të Republikës së Kosovës si dhe për kërkesat për akomodim që do të paraqiten në këtë vit. Në mbledhjen e kabinetit qeveritar i pari i kësaj ministrie, Mahir Jaghillar, ka thënë se aktualisht në hapësira me qira funksionojnë 16 institucione qendrore me 1 211 zyrtarë. Sipas tij, gjatë vitit 2019 totali i zyrtarëve të institucioneve që duhen akomoduar është rreth 2 600 dhe, sipas një parallogaritje akomodimi, brenda standardeve të përshtatshme për punë nevojiten rreth 40 deri në 50 mijë metra katrorë të hapësirave për punë. Si opsione të mundshme për zgjidhjen e kësaj problematike ai ka përmendur shpronësimin e disa objekteve, vazhdimin e sigurimit të hapësirave me qira edhe për një afat të caktuar ose me fillimin e procedurave për ndërtimin e kompleksit qeveritar për nevojat e institucioneve që janë akomoduar me qira. Qeveria i ka rekomanduar

Ministrisë së Administratës Publike që ta përfundojë analizën e kostove buxhetore për të gjitha opsionet e rekomanduara për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Ndërkaq, me kërkesë të kryeministrit Haradinaj, ministri i Financave, Bedri Hamza, ka informuar kabinetin lidhur me koncept-dokumentin për lojërat e fatit si një detyrim i trashëguar nga qeverisja e kaluar. Hamza ka deklaruar se ky koncept-dokument është derivat që rrjedhë nga obligimet e trashëguara nga qeveritë e kaluara dhe është në përputhje me dokumentet strategjike, programore dhe të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim. Sipas tij, koncept-dokumentin për lojërat e fatit është analizë dhe ai rekomandon që kjo fushë të rregullohet me ligj, i cili do të hartohet në përputhje me të gjitha procedurat për hartimin e legjislacionit në Kosovë.

Kurse kryeministri Haradinaj në fjalën e tij ka shprehur qëndrimin se, sa iu përket lojërave të fatit, të shqyrtohen të gjitha mundësitë, të përshtatshme me ligjet në fuqi, derisa ka shtuar se pas konsultimeve publike është e rrugës të shqyrtohet mundësia edhe e largimit të këtyre lojërave

në zonat periferike apo edhe mbyllja e tyre. "Unë i kisha hequr krejt këto lojëra të fatit. Nuk i kisha lënë fare në vendbanime", ka thënë Haradinaj. Një nga qëllimet e këtij koncept-dokumenti është që kjo fushë të rregullohet me ligj dhe të evitohet informaliteti në këtë fushë e cila në këtë fazë është mjaft e evidente.

Kryeministri Haradinaj ka kërkuar që të mos dëmtohen kompanitë vendore dhe të mos aplikohet masa e taksës 100 për qind për mallrat që kanë qenë në Kosovë deri në ditën kur është marrë vendimi. Ai ka thënë se është e kuptueshme që

një vendim i tillë i qeverisë të ndodhë sepse institucionet e Kosovës duhet të kenë kujdes ndaj sipërmarrësve vendorë. Por ky propozim i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë i lexuar nga Haradinaj nuk është përkrahur nga ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, i cili ka deklaruar se Qeveria nuk duhet të lëkundet nga vendimet e veta derisa të arrihet qëllimi politik.

Ndërsa zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë se fillimisht duhet të dihet sasia dhe lloji i këtij malli dhe të dhënat e tjera, tek pastaj të miratohet ky propozim. Derisa ministri i

Financave, Bedri Hamza, për sasinë dhe llojin e mallrave të pazhdoganuara nuk ka pasur informata, por ka premtuar se mund t'i sigurojë për një mbledhje të ardhshme. Derisa të sigurohen edhe këto të dhëna, kryeministri Haradinaj ka shtyrë këtë propozimvendim të MTI-së për një mbledhje të tjetër të Qeverisë. Në mbledhjen e së premtës të kabinetit qeveritar është miratuar edhe propozim vendimi për t'i propozuar Kuvendit të Kosovës zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin shkurt të vitit 2019, të përcaktuara me ligjin e buxhetit të vitit 2018.

## Haradinaj: Përfshirja e LDK-së dhe LV-së do ta fuqizonte Kosovën në dialog

**EPOKA  
ERE****M. KOCI**

**PRISHTINË, 11 JANAR** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se përfshirja e dy partive më të mëdha opozitare, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LV), në procesin e dialogut me Serbinë, do ta fuqizonte pozicionin negociues të Kosovës. Në një konferencë për media të premtën, pas mbledhjes së Qeverisë së Kosovës, Haradinaj ka thënë se opozita duhet ta shqyrtojë rolin e saj sa iu përket bisedimeve me Serbinë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. "Qëllimi dhe ajo çka e konsideroj si mision timin, është konsolidimi i argumenteve të brendshme të Kosovës, fuqizimi

i Kosovës në pozicionin negociues. Mendoj se edhe opozita duhet ta shqyrtojë rolin e vet. Pra, edhe LDK-ja, edhe Vetëvendosja ta fuqizojnë Kosovën në pozicionin negociues me Serbinë", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se në të kaluarën udhëheqësia e Kosovës ka dhënë prova të mjaftueshme për racionalitet.

Duke përdorur analogji sportive, Haradinaj ka theksuar se Kosova po luan në dy liga, atë të brendshme dhe të jashtme, andaj ka thënë se opozita e ka vendin e vet në procesin e dialogut, në mënyrë që Kosova të prezantohet sa më mirë karshi Serbisë. "Janë dy liga në të cilat po luhet. Një është e brendshme, ne i vazhdojmë garat tona politike të brendshme, për pushtet dhe për të tjera, por

është edhe një ligë e jashtme. Për këtë ligë e jashtme duhet ta bëjmë një kombëtare të Kosovës, një përfaqësuese të Kosovës. Aty e kanë vendin edhe LDK-ja, edhe Vetëvendosja. Nuk është mirë që ta dobësojnë kombëtaren e vet sepse janë çaste që janë me rëndësi kohore", ka deklaruar Haradinaj.

Partitë më të mëdha opozitare, LDK-ja dhe Vetëvendosje, po refuzojnë që të bëhen pjesë e procesit të dialogut me Serbinë. Ndërkaq, partia tjetër opozitare, Partia Socialdemokrate (PSD), është bërë pjesë e ekipit negociues, i cili përbëhet nga përfaqësuesit e partive në pushtet dhe bashkëkryesohet nga kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, dhe ai i PSD-së, Shpend Ahmeti.

Flet për "Epokën e re", Mimoza Kusari-Lila

# Ekipi për dialog s'ka peshë

Kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila, ka vlerësuar se dialogu me Serbinë është në kaos total për shkak të kërkesës së BE-së për heqjen e taksës dhe insistimit të Kosovës për ta mbajtur taksën deri në njohjen nga Serbia. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se mosinkuadrimi i dy partive më të mëdha në dialog ka bërë që ekipi negociator mos ta ketë peshën unifikuese dhe negociuese. Deputetja Kusari-Lila ka deklaruar se nuk do të mund të ketë vazhdim të dialogut në këto rrethana dhe me këtë përbërje të ekipit negociator. Sipas saj, zgjidhje për situatën e krijuar në Kosovë dhe për kaosin institucional janë zgjedhjet e jashtëzakonshme për kohën e organizimit të të cilave duhen marrë vesh partitë mes vete



**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 11 JANAR - "Epoka e re": Znj. Kusari-Lila, Kosova tashmë ka arritur ta ketë një ekip negociator për dialogun me Serbinë. Si e shihni mandatin e këtij ekipi dhe pse Alternativa nuk është pjesë e tij?

**Kusari-Lila:** Miratimi i rezolutës për dialog në Kuvend në formatin se si është bërë, gjegjësisht me mosinkuadrimin e dy partive më të mëdha opozitare, bën që ekipi për dialog nuk mund ta ketë peshën unifikuese dhe forcën negociuese. Situata politike në Kosovë kërkon domosdoshmërisht uljen në një tavolinë të të gjitha partive politike shqiptare për t'i diskutuar afatet kohore qoftë edhe për përcaktimin e datës së zgjedhjeve të reja, në mënyrë që të kemi një agjendë të mirëfilltë. Dialogu me Serbinë është në kaos total për arsye se në njërën anë kemi kërkesën e vazhdueshme të Bashkimit Evropian për heqjen e taksës, në anën tjetër qëndrimin e Kosovës për mbetjen e taksës deri në njohjen nga Serbia. Si do të dialogojë Kosova dhe a do të mbetet ky delegacion vetëm si delegacion shëtitës në diskutimet me BE-në, kjo mbetet të shihet. Megjithatë, fillimi nuk është premtues. Alternativa nuk është pjesë e ekipit për shkak se tashmë nuk mund të ketë ndonjë rezultat

konkret dhe ajo që është shkaktuar deri më tani me procesin e dialogut nuk mund të rregullohet. Alternativa me një vendim gati unanim të kryesisë së saj ka vendosur që para se të ngutemi që të kemi ekipin ta trajtojmë situatën e brendshme politike në Kosovë, të kemi një konsensus të partive politike dhe vetëm pasi të arrihet ky konsensus të jemi pjesë e procesit të dialogut.

"Epoka e re": Është e vërtetë se çështja e përfshirjes në këtë ekip ka ndikuar në përçarjen e Alternativës, përkatësisht në prishjen e raporteve tuaja me deputetin Ilir Deda?

**Kusari-Lila:** Mund t'i karakterizoj si mendime ndryshe, por jo përçarje, sepse Alternativa është e unifikuar dhe votimi në kryesi ka qenë unik. Propozimi i Ilirit për pjesëmarrje në ekip apo edhe për përfshirjen e Alternativës në ekip ka qenë në kohën kur është menduar se mund të ketë ndonjë ndryshim të ekipit në kuadër të procesit, por tash po e shohim se shanset janë minimale që të ketë vendime pozitive për Kosovën dhe dialogun.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh zhvillimet në Kosovë dhe në BE, prisni vazhdim të dialogut?

**Kusari-Lila:** Kosova duhet t'i ketë të përcaktuara vendimet dhe përfitimet. Në qoftë se mbahet

taksa atëherë duhet të përcaktohet afati dhe qëllimet e taksës. Nëse thuhet se taksën do ta mbajmë për të na njohur Serbia atëherë nuk kemi nevojë të shkojmë fare në dialog, të formojmë ekip dhe të ndajmë mjete pasi që synimi i dialogut është njohja nga Serbia. Përderisa kryeministri thotë se taksë nuk hiqet deri në njohjen e Kosovës nga Serbia atëherë nuk

ka nevojë që të humbim kohë dhe energji në dialog, por duhet ta presim efektin e taksës. Dyshoj se mbajtja e taksës do ta bëjë Serbinë që të njohë Kosovën. Në të kundërtën, do të ishin disa objektiva më të prekshme. Kryeministri për heqjen e taksës duhet të vendosë disa kërkesa për zbatimin e marrëveshjeve të përealizuara

siç janë marrëveshja për energjinë, për lëvizjen e lirë, për menaxhimin e kufijve e të tjera të cilat shkelen nga Serbia në mënyrë eklatante. Nëse vazhdohet kështu, Serbia do të gjejë forma të tjera të zhvillimit të saj ekonomik jashtë Kosovës, ndërsa Kosova do të mbetet e izoluar dhe pa ndonjë perspektivë në raport me integrimin.

## Veseli fton sërish në takim krerët institucionalë dhe opozitën për dialog

PRISHTINË, 11 JANAR - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, ka ftuar sërish në një takim të përbashkët presidentin, kryeministrin, ekipin negociator si dhe përfaqë-

suesit e grupeve parlamentare nga partitë opozitare ende të papërfaqësuar në ekipin negociator, LDK-në dhe LV-në, për t'u koordinuar për dialogun me Serbinë. Takimi do të mbahet

hënën (më 14 janar) në orën 11:00 në Kuvendin e Kosovës. LDK-ja dhe LV-ja deri më tani nuk i janë përgjigjur pozitivisht thirrjes së kryetarit të Kuvendit për të qenë pjesë e takimit.



# unifikuese dhe negociuese



**"Epoka e re":** Do ta përballojë Kosova presionin ndërkombëtar për heqjen e taksës?

**Kusari-Lila:** Kosova do të mund të vepronte shumë më mençur. Qeveria Haradinaj nuk sjell as vendime të mençura dhe as strategjike. Sikur t'i kishte objektivat e veta të qarta dhe të matshme nuk do të kishte nevojë që presioni të bëhet vetëm mbi

Kosovën, por presioni do të kthehej nga Serbia që t'i realizonte kërkesat e Kosovës siç është zbatimi i marrëveshjes për energjinë, ta zëmë brenda disa jave apo një muaji, zbatimi i marrëveshjes për lëvizje të lirë, lirimi i urës në Mitrovicë, zbatimi i marrëveshjes së kufijve dhe zbatimi i marrëveshjes për njohjen e diplomave. Të gjitha

këto pastaj do të bënin që faktori ndërkombëtar ta shtojë presionin ndaj Serbisë që t'i zbatojë marrëveshjet që i ka nënshkruar. Në këtë formë faktori ndërkombëtar është duke i bërë presion vetëm Kosovës pa marrë parasysh se Serbia vazhdon t'i shkelë marrëveshjet dhe të bëjë probleme serioze për Kosovën dhe qytetarët e saj. Rastin e fundit

e kemi maltretimin që po u bëhet mërgimtarëve tanë në kufi. Askush nuk e ngre zërin për atë çështje nga faktori ndërkombëtar, të gjithë e ngrehin zërin për taksën. Ky veprim i Qeverisë Haradinaj është i pamatur dhe i pamenduar mirë. Është një sharllantizëm politik në formën e vet se si është shpërfaqur që të insistohet se mbajtja e taksës deri në njohjen e Serbisë. Serbia nuk do të na njohë dhe taksës mund t'i humbë efekti pas një kohe dhe në fund nuk kemi arritur asgjë me këtë proces.

**"Epoka e re":** Nuk mendoni se taksa mund ta fuqizojë pozicionin e Kosovës në dialog?

**Kusari-Lila:** Jo. Unë jam që të mbahet taksa por, gjithashtu, jam që të vendosen disa kushte të tjera për heqjen e saj. Të kuptohemi drejt: jam që taksës t'i vendosen objektivat e matshme. Do të thotë taksa mbahet derisa Serbia nuk fillon respektimin e marrëveshjes për energjinë, për lëvizjen e lirë, për menaxhimin e kufijve apo edhe derisa nuk hyjmë në negociata për lirim dhe hapësirës ajrore, sepse kemi problem serioze të kostos së fluturimeve në Kosovë për faktin se asnjë avion që vjen nga vendet e tjera nuk mund të fluturojë mbi Serbinë, por duhet të shkojë përreth me çka edhe rritet kostoja e udhëtarëve. Taksa të mbahet, por duhet të jetë një kusht tjetër, dhe jo kushti i njohjes. Në të kundërtën, Kosova publikisht duhet të thotë se tërhiqet nga dialogu me Serbinë dhe forma e vetme që pret për ta njohur Serbia është përmes taksës.

**"Epoka e re":** Këtë vit prisni lëvizje pozitive sa i përket procesit të integritimit evropian për Kosovën apo do të mbesim të varur nga dialogu?

**Kusari-Lila:** Përderisa e kemi Qeverinë Haradinaj në pushtet Kosova nuk do të ketë zhvillime pozitive as në raport me integritet e as në raport me zhvillimet e brendshme. Kjo Qeveri nuk i ka sjellë të mira Kosovës dhe nuk do t'i sjellë sepse nuk mendon

strategjikisht dhe as në të mirë të vendit. Deri në momentin kur të ndërrohet kjo Qeveri, Kosova do të jetë e bllokuar dhe e izoluar ashtu siç është sot.

**"Epoka e re":** Së shpejti pritet të fillojë sesioni pranveror i Kuvendit të Kosovës. Do të ketë Kuvendi një rol më të madh korrigjues dhe mbikëqyrës ndaj kësaj qeverie?

**Kusari-Lila:** Kuvendi duhet ta ketë rolin e tij dhe të gjithë deputetët pa përjashtim, pozitë dhe opozitë, duhet t'i marrin seriozisht detyrat e veta. Deri më tani ka pasur probleme serioze në mbarëvajtje të seancave dhe mungesë së kuorumit, por shpresoj se në këtë vit Kuvendi të ketë një aktivitet të shtuar monitorues dhe korrigjues ndaj Qeverisë Haradinaj, pse jo edhe rrëzimin e saj.

**"Epoka e re":** Pajtoheni me konstatimin e LDK-së dhe të Vetëvendosjes, se zgjidhja më e mirë është shkuarja në zgjedhje të parakohshme?

**Kusari-Lila:** Absolutisht se zgjidhje për situatën e krijuar në Kosovë dhe për kaosin institucional janë zgjedhjet e jashtëzakonshme, për kohën e organizimit të të cilave duhen marrë vesh partitë mes vete. Qëndrimi ynë dallon me ata sepse ne mendojmë se duhet të ketë një qëndrim mes partive politike. Qeverisja Haradinaj nuk e ka potencialin dhe mundësinë që të bëjë zhvillime pozitive për Kosovën, prandaj vetëm po e degradon shtetin.

**"Epoka e re":** Nëse nuk do të ketë dakordim për shkuarje në zgjedhje si e shihni ecurinë e proceseve, përkatësisht vazhdimin e dialogut? Prisni arrijten e një marrëveshje të dobishme për Kosovën?

**Kusari-Lila:** Shanset janë minimale që të arrihet çfarëdo marrëveshje. Nuk besoj se do të kemi vazhdim të dialogut në këto rrethana dhe me këtë përbërje të ekipit.

## Mustafa: Disponimi i LDK-së është të rrëzohet kjo Qeveri

PRISHTINË, 11 JANAR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka mbajtur të premtën konferencë për media, në të cilën ka folur edhe për synimin e kësaj partie për ta rrëzuar Qeverinë. "LDK-ja është opozitë. Ne votën e kemi marrë prej qyte-

tarëve që të jemi opozitë. Jemi deklaruar që kontributin tonë do ta japim në Kuvend për dialogun. E kemi edhe dokumentin bazë që e kemi aprovuar në lidhje me parimet se çfarë mund të dialogohet e çfarë jo. Ndërkohë edhe ndërkombëtarëve me respekt u

kemi thënë që ne do ta japim kontributin, por kjo është qasja jonë, sepse qeveria duhet ta marrë përgjegjësinë për dialogun dhe të mos mundohet ta hedhë tek opozita", ka thënë Mustafa, duke shtuar se disponimi i LDK-së është që të rrëzohet kjo Qeveri.



## Murati: Nuk do të jetë e largët dita kur gjysma e qeverisë në Tiranë do të përbëhet nga kosovarët



PRISHTINË, 11 JANAR (ER) - Kryetari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Valon Murati, ka thënë se mosdekretimi i Gent Cakajt për ministër të Punëve të Jashtme të Shqipërisë është produkt i betejës së brendshme politike në Tiranë. "I pështirë ekzaltimi meskin i disave në Prishtinë për këtë mosdekretim. Ndërsa sa i përket ridefinimit të kufijve me Serbinë, ai është një proces i cili drejtpërdrejt i takon Kosovës

dhe qytetarëve të saj. Tirana zyrtare duhet t'i qëndrojë përkrah Prishtinës ashtu siç tradicionalisht ka bërë çdoherë dhe rrjedhimisht ministri i Punëve të Jashtme i Shqipërisë nuk mund të jetë bartës i këtij procesi", ka shkruar Murati në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se nuk do të jetë e largët dita kur gjysma e Qeverisë në Tiranë do të përbëhet nga kosovarët. "Në anën tjetër, po

vazhdoj të habitëm tashmë që disa muaj se si në Kosovë ka njerëz që më shumë e duan Leposaviqin se Preshevën. E sa për provincialistët e bllokut në Tiranë dhe provincialistët kosovarista që iu gëzuan mosdekretimit të Gent Cakajt, ekzaltimin nuk do ta kenë të gjatë. Nuk do të jetë e largët dita kur gjysma e qeverisë në Tiranë do të përbëhet nga kosovarët", ka deklaruar Murati.

## Limaj në Prizren prezanton aderimet e reja të Nismës



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRIZREN, 11 JANAR - Nismës Socialdemokrate, degës në Prizren, i janë bashkuar të premtën dhjetëra ish-aktivistë e drejtues të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në këtë qytet. Në një konferencë për media të Nismës, ku i pranishëm ishte edhe kryetari i këtij subjekti poli-

tik, Fatmir Limaj, janë prezantuar aderimet e reja. Në Nisma Socialdemokrate kanë aderuar: Esat Krasniqi, Shukri Quni, Naser Berisha, Hajrim Qengaj dhe Hysamedin Beshi, të gjithë këta anëtarë të Kryesisë në Prizren dhe tre nga ta kryetarë të nëndegëve. Në mesin e të aderuarve ka edhe asamblistë. Bëhet fjalë për Shukri Qunin, i cili është asamblist në mandatin e katërt në Komunën e

Prizrenit nga radhët e PDK-së. Gjithashtu, të premtën në Nisma kanë aderuar edhe dr. Hajrip Ajdini, Fatmir Hoxhaj dhe dhjetëra aktivistë të tjerë. Mirëseardhje në emër të Nismës iu ka uruar vetë lideri i këtij subjekti politik, Fatmir Limaj, i cili ka thënë se sot është një moment i veçantë për Degën e Nismës në Prizren dhe Nismën në përgjithësi. Sipas tij, të gjithë të

aderuarit kanë një histori të madhe në shërbim të vendit. "Kjo është familja e juaj politike. Ne do të vazhdojmë bashkë. Jemi bashkuar për të mirën e vendit. Angazhimi tregon se ju jeni gati për t'i dhënë Prizrenit dhe Kosovës më të mirën nga vetja juaj", ka thënë Limaj. Ndërkaq deputeti dhe kryetari i Nismës Socialdemokrate në Prizren, Zafir Berisha, ka thënë se

sot po bëhen bashkë me idenë dhe qëllimin që të organizohen dhe të punojnë në funksion të përmirësimit të jetës së të gjithë qytetarëve të Prizrenit pa dallime politike dhe etnie. "Objektivi i Nismës në Prizren dhe Kosovë është të qëndrojmë pranë njerëzve që kanë nevojë për dorën e shtetit. Ne do të jemi tani me të fuqishëm në Prizren dhe Kosovë pas këtyre aderimeve", ka thënë Berisha.



## Lulzim Tafa, anëtar i Akademisë edhe në Francë

PRISHTINË, 11 JANAR (ER) - Poeti i njohur kosovar Lulzim Tafa, i cili po arrin suksese të vazhdueshme në arenën ndërkombëtare, librat e të cilit janë përkthyer edhe në gjuhën frënge dhe i cili ka qenë

disa herë pjesëmarrës në festivale të ndryshme të letërsisë në Francë, është zgjedhur së fundmi anëtar i Akademisë së Shkencave, Arteve dhe Letërsisë në Paris të Francës.

Anëtarë të jashtëm të Akademisë zgjidhen figura eminente botërore të fushës së shkencës, artit dhe letërsisë. Akademia Evropiane e Shkencave, Arteve dhe Letërsisë në Francë ka rreth

200 anëtarë të listës së notave, në mesin e të cilëve edhe tetëmbëdhjetë fitues të Çmimit Nobel. Tafa është ftuar në Paris më 25 janar për të marrë pjesë në ceremoninë e inaugurimit anëtar i Akademisë.

# Kërcënimet me greva



**PRISHTINË, 11 JANAR** - Greva po bëhet gjithnjë e më tepër si forma më e preferuar e punonjësve në sektorë të caktuar publikë për shtimin e presionit ndaj Qeverisë për rritje të pagave dhe për kushte më të mira të punës. Grevat po organizohen si formë e pakënaqësisë që nga fillimi i këtij viti nga punëtorët të cilët paguhen nga buxheti i Republikës së Kosovës. Edhe pse grevat po realizohen në forma dhe sektorë të ndryshëm, emëruesi i përbashkët i kërkesës të tyre është rritja e pagave. Viti filloi me grevën e punonjësve të sektorit të shëndetësisë, por të cilët në masë të madhe e ndërprejnë atë, pas premtimeve që morën nga Qeveria. Megjithatë, kirurgët nuk janë bindur nga ato premtime dhe po e vazhdojnë grevën.

Minatorët e kompleksit metalurgjik "Trepça" që nga 3 janari janë në grevë të

përgjithshme, duke kërkuar rritjen e pagave për 20 për qind. Kurse Sindikata e Arsimit ka paralajmëruar se më 14 janar do të fillojë greva në gjithë sektorin e arsimit, nga kopshtet e deri tek institucionet e larta universitare. Ata po kërkojnë rishikimin e Ligjit të pagave, me të cilin po kërkojnë ngritjen e pagave për mesimdhënësit me 30 për qind. Arsyet e grevave të punëtorëve të këtyre sektorëve i përkrah edhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK).

Avni Ajdini, kryetar i BSPK-së, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se shpërfaqjen e pakënaqësive të punëtorëve përmes grevave po e nxit, siç thotë ai, Qeveria e Kosovës. Grevat janë vazhdimësi e pakënaqësive të vitit të kaluar, thotë ai, kur Qeveria e Kosovës rriti pagat për zyrtarë të lartë të saj, Qeveri kjo e cila ka numër të madh të

zëvendësministrave dhe këshilltarëve. "Njëherë i ngacmoi, provokoi punëtorët me rritjen e pagave, tashmë i ngacmoi me numrin e madh të këshilltarëve. Kjo është çështje shumë e ndjeshme. Pagat që u rritën në përqindje të lartë për zyrtarë të Qeverisë dhe jo për punëtorët, i nxit të gjitha federatat që të organizojnë greva të ndryshme për realizimin e të drejtave të tyre. Të gjitha kërkesat janë legjitime në përputhshmëri me ligjet dhe konventat ndërkombëtare për punëtorët. Kurse, sa i përket kërkesës së kirurgëve, nuk kam të drejtë të flas për shkak se nuk janë anëtarë i BSPK-së", ka theksuar në vazhdim ai.

Ndryshe rritja e pagave për minatorët është vlerësuar e pamundshme nga ministri i Zhvillimit Ekonomik në Qeverinë e Kosovës, Valdrin Lluka. Kurse sa i përket kërkesës së SBASHK-ut, kryem-

inistri i Kosovës, Ramush Haradinaj, të premtën ka thënë se në këtë sektor kanë ndodhur disa përmirësime, ndërsa mundësitë e tjera, siç është shprehur ai, do të shikohen me Ligjin për Pagat. Ky ligj, ka deklaruar Haradinaj, në mënyrë të veçantë i trajton edhe pagat e mjekëve.

Pritjet janë që Projektligji për Pagat ta rregullojë sadopak situatën kaotike me pagat në sektorin publik. Kështu të paktën pret vetë kryeministri Haradinaj.

Por, ky Projektligj është duke u shqyrtuar në Komisionin për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media në Kuvendin e Kosovës dhe me procedurë të shpejtë pritet të kalojë në një rën nga seancat e para të Kuvendit të Kosovës për miratim.

Kryetari i këtij Komisioni në Kuvendin e Kosovës, Nait Hasani, ka thënë për "Radion

Evropa e Lirë" se deri në fund të këtij muaji pritet miratimi i këtij ligji, i cili, sipas tij, mund të pësojë edhe disa modifikime të arsyeshme. "Të gjitha amendamentet e arsyeshme do të inkorporohen si pjesë e ligjit dhe do të jenë ato mundësi që ne i favorizojmë për një stabilitet dhe një nivelizim të pagave. Mua më intereson që Ligji për Pagat, të ketë parim; për punën e njëjtë - pagë të njëjtë, ky të jetë parim dhe bazë i udhëheqjes së pagave në nivel të Kosovës", është shprehur Hasani.

Ky projektligj pritet të miratohet në seancat e para të Kuvendit të Kosovës, me të mbaruar pushimet dimërore për deputetët. Miratimi i këtij Ligji është vendosur si kusht nga Partia Socialdemokrate e Kosovës, për ta votuar Buxhetin për vitin 2019, pasi Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur ta miratojë ende Buxhetin për këtë vit.

## Haradinaj bën homazhe te varri i Rugovës dhe viziton familjen e tij

**PRISHTINË, 11 JANAR (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë homazhe të premtën te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova si dhe ka vizituar familjen e tij. Ai ka thënë se janë duke e vazhduar trashëgiminë politike të

Rugovës. "Sot kam bërë homazhe te varri i presidentit historik Ibrahim Rugova dhe ndava disa çaste me familjen e tij të nderuar, së cilës i urova mbarësi në këtë vit. Në frymën e trashëgimisë së tij politike ne po vazhdojmë rrugën për një

Kosovë të zhvilluar dhe të integruar në të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë, me orientim përëndimor dhe në miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka thënë Haradinaj pas vizitës në familjen Rugova.



## Rrugët e Gjilanit janë të hapura, apelohet për kujdes të shtuar

GJILAN, 11 JANAR (ER) - Komuna e Gjilanit është duke intervenuar gjatë gjithë kohës për hapjen e rrugëve pas reshjeve të fundit të borës. Kështu ka njoftuar drejtori i Shërbimeve Publike, Infrastrukturës dhe Banimit, Naser Korça, i cili ka bërë me dije për angazhimin maksimal të stafit të komunës dhe operatorit ekonomik që gjithçka të tejkalohet në normalitet të plotë. Ai ka thënë se së bashku edhe me institucionet e tjera në Komunën e Gjilanit janë në gjendje gatishmërie për të ofruar mbështetje të plotë në rast të paraqitjes së nevojës për intervenim. "Kompania e cila ka për detyrë mirëmbajt-

jen e rrugëve dhe hapjen e tyre është duke vepruar në gjithë hapësirën e Gjilanit. Komuna apelon te të gjithë qytetarët e Gjilanit të kenë kujdes të shtuar gjatë qarkullimit në komunikacion dhe përdorimin e pajisjeve dimërore në mënyrë që t'i evitohet aksidentet ose problemet e tjera që mund të ndodhin", ka thënë Korça. Komuna e Gjilanit ka njoftuar qytetarët që për çdo problem që eventualisht mund të hasin t'i kontaktojnë numrat kujdestarë: +383 44 234 007 dhe +383 45 540 803 dhe ekipet komunale do t'u përgjigjen në kohën më të shpejtë të mundshme.



## Lladrovci emëron dy drejtoresha të reja

DRENAS, 11 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka plotësuar ekzekutivin me emërimin edhe të dy drejtorive të cilat do të udhëhiqen nga femrat. Tash e tutje në Komunën e Drenasit drejtoritë me shumicë i udhëheqin gratë, nga gjithsej dymbëdhjetë drejtori, shtatë prej tyre do

të udhëhiqen nga femrat dhe pesë nga meshkujt. Shqipe Zogu do ta udhëheqë Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ish-asambletiste e Kuvendit Komunal në Drenas për dy mandate dhe Egzona Jetullahi do ta udhëheqë Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik. Drejtorinë e Infrastrukturës Publike do ta

drejtojë Idriz Hysenaj, Flutura Avdiu drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Anita Abdullahu drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Shyqyri Bublaku drejtorinë për Buxhet dhe Financa. Drejtoritë e tjera do të drejtohen nga drejtorët aktualë.

## Komuna e Ferizajt dënon rastin e vrasjes së maces së egër



FERIZAJ, 11 JANAR (ER) - Komuna e Ferizajt, përkatësisht Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, përmes Shoqatës së Gjuetarëve "Shqiponja", ka marrë informacionin nga terreni dhe ka denoncuar në Policinë e Kosovës rastin e vrasjes së maces së egër (felis silvestris), kafshë kjo e mbrojtur me ligj në Kosovë, përkatësisht specie e rrezikuar dhe e hasur në numër shumë të ulët për shkakun e ndikimit negativ të faktorit njeri dhe shkatërrimit të habitatit të tij. "Një akt i tillë barbar varfëron faunën tonë dhe rrezikon zhdukjen përfundimtare të kësaj specie të mbrojtur me

ligj. Autoritetet lokale si vazhdimësi të bashkëpunimit me Policinë e Kosovës kanë marrë njoftimin se është arrestuar një shtetas për këtë rast, qytetar i Ferizajt nga fshati Pleshinë dhe se po kryhen hetimet e nevojshme si dhe procedurat paraprake të parapara me legjislacionin në fuqi", ka njoftuar Komuna e Ferizajt. Sipas këtij njoftimi, Komuna e Ferizajt pret verdiktin e gjykatës përkitazi me këtë rast, duke besuar se gjyqësori do ta japë shembullin e duhur për mbrojtje të faunës sonë dhe që raste të tilla të mos përsëriten më.

## Muharremaj falënderon kompanitë që ndihmuan për pastrimin e rrugëve në Suharekë

SUHAREKË, 11 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka falënderuar kompanitë të cilat në mënyrë vullnetare kanë ndihmuar për pastrimin e rrugëve të kësaj komune pas reshjeve të borës. Me

këtë rast, Muharremaj ka ftuar të premtën në takim pronarët e këtyre kompanive, për të cilët ka thënë se janë vlerë për komunën që drejtohet nga ai. "Jam falënderues ndaj të gjitha kompanive të cilat na ndihmuan në mënyrë

vullnetare për pastrimin e borës nga rrugët. Ky shembull i mirë ka treguar vlerë të veçantë për komunën tonë, andaj në emër të qytetarëve sot i kam ftuar dhe i kam falënderuar për kontributin", ka thënë Muharremaj.





## Çmimet e konsumit shënuan ngritje 2.9 për qind

PRISHTINË, 11 JANAR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit" (IHÇK) për muajin dhjetor të vitit 2018, viti bazë 2015=100. Sipas ASK-së, shkalla mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2018 ishte 1.1 për qind. "Inflacioni mujor i matur nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte 0.8 për qind në dhjetor 2018 krahasuar me muajin nëntor 2018. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: bukë dhe drithëra (2.6 për qind); qumësht, djathë dhe vezë (2.9 për qind); perime

(10.8 për qind); dru zjarri për ngrohje (4.7 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.9 përqindësh në IHÇK", është thënë në raportin e ASK-së. Sipas këtij raporti, ngritja u neutralizua nga rënia e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: përdorim i pajisjeve për transportin personal (-0.9 për qind) dhe rënie e çmimit të naftës dhe benzinës me një ndikim të këtij nëngrupi prej (-0.1 përqindësh) në IHÇK. "Shkalla e inflacionit e matur në muajin dhjetor 2018 me muajin dhjetor 2017 ishte 2.9 për qind. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë për 2.9 për qind

në muajin dhjetor 2018 krahasuar me muajin dhjetor 2017. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te nëngrupet e COICOP-it: bukë dhe drithëra (7.8 për qind); mish (4.3 për qind); qumësht, djathë dhe vezë (4.3 për qind); perime (21.1 për qind); pije alkoolike (2.9 për qind); duhan (2.9 për qind); përdorim i pajisjeve për transportin personal (10.5 për qind); çmimet e naftës dhe benzinës, shërbimet për transport (3.5 për qind); çmimet e biletave të transportit ajror, shërbimet hoteliere (2.3 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 3.4 për qind në IHÇK",



është cituar në raportin e ASK-së. Sipas këtij raporti, ngritja u neutralizua, kryesisht nga rënia e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: pemë (-12.1 për qind); sheqer, reçel, mjaltë, çokolatë dhe ëmbëlsira (-3.2 për qind); ujë, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (-0.7 për qind); energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera

djegëse (-1.9 për qind), orenditë dhe aparataturat, qilima dhe shtroja të tjera për dysheme (-2.0 për qind); pajisje telefonike dhe të telefaksit (-4.7 për qind); pajisje audiovizuale, fotografike për përpunimin e informative (-2.5 për qind), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0.5) për qind në IHÇK.

# Haradinaj kërkon që Kosova të ndihmohet përmes investitorëve të rinj

Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije të premtën se me ministrin e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, është biseduar për mundësinë që do t'ua japin investitorëve të rinj. Ai ka bërë thirrje që të ndihmohet Kosova për t'i arritur rezultatet përmes këtyre bizneseve të reja

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 JANAR - "Qeveria e vendit do të jetë partnere e bizneseve në zhvillimin e tyre. Ky vit është viti i ekonomisë dhe në këtë drejtim na duhet ndihma e të gjithëve", kështu ka thënë të premtën kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, pasi ka zhvilluar një takim pune në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka thënë se ministri Beqaj paraqiti të gjitha projektet që ka ministria



gjatë këtij viti, duke qenë edhe partnere e bizneseve inovative në përkrahjen e tyre, sidomos në digjitalizim. Kryeministri Haradinaj më tutje ka theksuar se është biseduar edhe për mundësinë që do t'ua japin investitorëve të rinj dhe me këtë

rast inkurajoi të ndihmohet Kosova për t'i arritur rezultatet përmes këtyre bizneseve të reja që të fitohen brende të tjera. "Ne i kemi disa brende shumë të mira në sport, pra kemi arritur nivelet botërore dhe shpresoj se edhe me disa kompani, që kanë arritur treg-

jet botërore, të ecim përpara", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke shtuar se Kosova eksporton shërbime të këtyre bizneseve inovative, digjitale në vlerë rreth 30 milionë euro, duke qenë kështu i vetmi sektor, ku bilanci është pozitiv.

Ndërkaq ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, u shpreh i kënaqur me vizitën e kryeministrit Haradinaj, duke treguar se biseduan për vitin ekonomik të shpallur nga vetë kryeministri e, po ashtu, edhe t'i bashkërendojnë aktivitetet e tyre.

## Ministria e Zhvillimit Rajonal, sesion informativ rreth granteve

PRISHTINË, 11 JANAR - Ministria e Zhvillimit Rajonal ka njoftuar se së shpejti do të lansojë skemën e radhës për grante për biznese dhe startup. Me qëllim të informimit më të mirë të aplikuesve do të

organizohen sesionet informuese, pastaj do të lansohet edhe thirrja menjëherë pas sesioneve. "Thirrja e radhës do të lansohet përmes platformës SMAED online platforma qeveritare dhe aplikimi do të

bëhet vetëm online. Gjatë sesioneve informuese aplikantët potencialë do të njoftohen për mënyrën e regjistrimit në SMAED dhe për kriteret e thirrjes dhe për mënyrën e aplikimit. Andaj, ju ftoj të gjithëve

të merrni pjesë në këtë sesion informativ më 15. 1. 2019, ditë e martë, në kuvendin komunal/komuna e vjetër, nga ora 11:00", bëhet me dije në njoftimin për media të kësaj ministrie.



# Ç'doni ju, shqiptarët e serbizuar dhe të kosovarizuar?!



Behxhet Sh. SHALA -  
BAJGORA

Kush po na mbron, kush po na mbron: Edi Rama ishte shpresa e shqiptarëve kudo që jetonin ata se, më në fund, po del dikush që ka kapacitet intelektual, moral, kombëtar dhe politik t'i përfaqësojë dhe mbrojë interesat e tyre. Me një oratori që tejkalonte standardet shqiptare dhe, në shumë raste, edhe ndërkombëtare, me një shpirt artisti apo bohemi, me një intelektualizëm të theksuar, me një opozitarizëm që për atë kohë ishte përtej çdo imagjinate të shqiptarët, me një prirje dhe me një vullnet ta mbrojë ambientin duke e pastruar Tiranën nga mbindërtimet dhe lokalet që e ngufasnin çdo hapësirë gjelbëruese apo mushkëritë për qytetarët, me ndryshimin e fytyrës së Tiranës duke i shndërruar fasadat e zymta në një hapësirë me ngjyra që pushonin sytë, me një qëndrim atëror apo paternalist për shqiptarët që jetonin jashtë kufijve të Shqipërisë si dhe me një qëndrim të fortë ndaj agresionit verbal dhe praktik të shovinistëve serbë të Serbisë përfitoi zemrat e të gjithë shqiptarëve, përrjash-tuar këtu Sali Berishën dhe Lul Bashën. Edvin Ramën e ka përkrahur në çdo aspekt edhe Abetarja dhe Akademia Kombëtare, Bacë Adem Demaçi, ndonëse po ky Edi Rama, kur vinte në Prishtinë, por edhe në Tiranë, gjente kohë të takohej me rrugaçë ordinerë që sot po e sulmojnë si dhe të tillë që kanë qenë pjesë e Serbisë në institucionet e Kosovës e që kanë përrallitur në gjuhën shqipe dhe të cilët në jetën e tyre nuk e kanë lexuar as edhe një libër të vetme dhe as që e dinë se sa shkronja i ka alfabeti i gjuhës shqipe, mirëpo nuk ka gjetur kohë ta vizitojë asnjëherë Bacë Adem Demaçin. Një ndër intelektualët më të mëdhenj të shqiptarëve, kudo që jetojnë, Rexhep Qosja e ka përkrahur me patos të jashtëzakonshëm Edi Ramën, kam përshtypje, më shumë për inat të Sali Berishës sesa që është bindje e besimit. Dihet mirëfilli se proceset e mëdha

botërore janë vënë në lëvizje, jo sa libra keni shkruar, por sa keni aftësi oratorike për t'i thënë si duhet dhe në vend ku duhet disa citate të një libri të cilin nuk e keni lexuar të tërin. Këtë aftësi e ka, pa asnjë dyshim, edhe Edi Rama që superioritetin e tij e keqpërdori edhe në Kosovë, duke i bërë përrallë disa gazetarë dhe pjesëtarë të shoqërisë civile, servilë të të gjitha garniturave të pushtetit në Kosovës dhe rrogëtarë të ndërkombëtarëve. Edi Rama në Kosovë vetëm po e përkrah Besa Shahinin që e bëri ministre dhe Genc Cakajn që nuk arriti ta bëjë ministër, ndonëse deklaroi se ka lexuar më shumë libra se të gjithë ata që po e kundërshtojnë emërimin e Genc Cakajt, ministër për Punë të Jashtme dhe Evropën. Do të isha shumë subjektiv dhe i padrejtë nëse harroj ta përmend edhe presidentin aktual të Kosovës, Hashim Thaçin, që e gëzon përkrahjen 100 % të Edi Ramës për faktin se presidenti ynë është intelektual i kalibrit të jashtëzakonshëm dhe se ka lexuar më shumë libra se Genc Cakaj + Besa Shahini dhe Edi Rama e mos ta përmendim këtu injorantën që e kritikojnë presidentin Thaçi e që paskan lexuar një numër simbolik të librave, disa mijëra sosh. Pastaj, presidenti ynë është poliglot që ia kalon edhe të ndërjet Haxhi Merxha që thoshte se i fliste shtatë gjuhë, në mesin e tyre edhe gjuhën italiane. Kur e pata pyetur Haxhi Merxhën se sa e flet gjuhën italiane dhe rregullat e shkrimit të fjalëve addio dhe arrivederci, ai, në një copë letër shkroi, adijo dhe arivederqi, ashtu si i shqiptonte. Fondi i tij ishte simbolik, por me bindje i mbron sikur të ishte pasardhës i Dante Aligerit. Edi Rama, me përkrahjen që ia bën presidentit Thaçi për korrigjim të kufijve dhe me cilësimin se janë gomarë të gjithë ata që dyshojnë në përcaktimin dhe përmbytjen patriotike të Hashim Thaçit, po tregon se është mashtrues dhe manipulues ordiner. I ka mashtruar të gjithë, madje edhe mua që e kam përkrahur deri vonë, ndonëse njohësit e rrethanave politike, e sidomos të jetës rozë në Shqipëri, e që të tillë ka shumë, bënë përpjekje të më bindnin se Rama është si doktor Xhekili, është person me dy a më shumë fytyra dhe se patriotizmin e përdor si armë për idealistët dhe budallenjtë që

besojnë në bashkim kombëtar, si puna ime dhe të tjerët. Ata për Ramën jepnin edhe cilësime psikologjike dhe psikiatrike e që për mua, në mungesë të kompetencës, ishin të papranueshme. E them publikisht se midis Sali Berishës dhe Edi Ramës nuk kam pasur asnjë dyshim se kë duhet ta përkrah: Edi Ramën, pa asnjë dyshim. Gabim, sepse duket se në përmbytje nuk dallojnë asgjë, dallojnë vetëm në formatin dhe dukjen e lëkurës me të cilën janë përshtjellur. Me një fjalë, pamja ndryshon, përmbytja thuaja është e njëjtë apo, siç thoshte Xhaxhi Enver i disa shokëve të mi kur eliminonte kundërshtarët politikë: dalin të jenë karrieristë të qelbur! Edhe Berisha, edhe Edi Rama! Duke përkrahur Hashim Thaçin për korrigjim të kufijve, Edi Rama nuk dallon aspak nga politika e Beogradit dhe e Serbisë! Edi Rama është mospërfillës dhe i fyen të gjithë ata që e kundërshtojnë Edin si dhe vartësitë e tij. E sidomos ata që nuk thonë se presidenti Hashim Thaçi është Xhorxh Uashingtoni i Kosovës. Ia bëri një injorim publik edhe kryeministrit të Kosovës kur ky theksoi se nuk pranon kurrë që çështja e kufijve të jetë temë e bisedimeve apo pjesë e marrëveshjes. Së fundi e sulmoi edhe Edita Tahirin shkaku se ka përkrahur presidentin Meta i cili nuk e dekretoi Genc Cakaj, kotillën politike të Batonit dhe të Thaçit si dhe të Ramës për ministër të Jashtëm të Shqipërisë. Në mos asgjë tjetër, Edita Tahiri, krahasuar me Genc Cakajn, ka përparësi sepse i njeh më mirë rrugët e Brukselit, butikët ekskluzivë në Bruksel si dhe itinerarin e fluturimeve Prishtinë - Bruksel. I ka bërë do fusnota dhe yje që u mbijetuan edhe temperaturave të larta dhe nuk u shkrinë: "si një fjollë bore", por tash fuqishëm po kundërshton korrigjimin e kufijve! Nëse e ka sinqerisht?! A duhet të pushkatohet presidenti Ilir Meta?! Kurrë nuk kam qenë në dashuri të madhe me Ilir Metën i cili në politikën shqiptare e luajti lojën e një king makeri, prandaj asnjëherë nuk mbeti pa poste. Duket se as Ilir Meta nuk është në dashuri të madhe me Edi Ramën, kryeministër i Shqipërisë, me pretendime të jetë edhe baba i shqiptarëve, kurse për trashëgiminë politike të Ismail Qemalit po bën rivalitet me Hashim Thaçin, presidenti i

Kosovës deri në vitin 2019. Ilir Meta është president i Shqipërisë dhe mbi të është vetëm Kushtetuta e Shqipërisë e cila ia jep autorizimet që i takojnë si president dhe për të cilat ka ekskluzivitet. Një ndër të është edhe dekretimi apo mosdekretimi i ministrave të propozuar nga kryeministri i Shqipërisë, në rastin konkret nga Edi Rama. Edi Rama propozoi dy kandidatë nga Kosova: Besa Shahinin dhe Genc Cakajn. Besa Shahinin e dekretoi pas sqarimeve plotësuese, kurse dekretimin e Genc Cakajt e refuzoi e që shkaktoi valë reagimesh "vullkanike" nga autoritetet e mëdha kombëtare (nuk e di cilit komb), Baton Haxhiu dhe vetë Edi Rama. Baton Haxhiu i dërgoi një letër presidentit të Shqipërisë me të cilin e denoncon se bën gabim historik nëse nuk e dekreton Gencin e që letra, si për nga përmbytja dhe adresimi, dukej si komunikim rrugaçësh e jo një midis një "intelektuali" dhe një presidenti. Ilir Meta ka plotësisht të drejtë që e ka refuzuar dekretimin e Genc Cakajt shkaku se nuk e plotëson asnjë kusht për atë post me përgjegjësi. Arsyetimi i refuzimit është i mbuluar 100 % me fakte profesionale, politike, kombëtare, morale dhe shtetërore. Pohimi i Edi Ramës, se Genci paska lexuar shumë libra, është i parëndësishëm për faktin se ministri për Punë të Jashtme i Kosovës, Behgjet Pacolli, jo që ka lexuar shumë libra, por edhe ka shkruar shumë libra! Edi Rama nuk ka pse të kërkojë falje Kosovës që presidenti Ilir Meta, me plot të drejtë dhe mbështetur në Kushtetutën e Shqipërisë, nuk e paska dekretuar pjellën politike të Batonit, Hashimit dhe Edit për ministër të Shqipërisë, aq më parë që askush në Kosovë nuk e çanë prapancën për këtë mosdekretim, përveç treshit të keq, Batonit, Hashimit dhe Edit. Pastaj, a nuk paska në Shqipëri njerëz më të zotë që do të udhëhiqnin këto ministri dhe u dashka të importohen nga Kosova, autorët e të cilëve duan të krijojnë një identitet të paqenë kombëtar - identitetin kosovar dhe të gjithë ata që janë angazhuar dhe angazhohen për bashkim kombëtar i kanë pushkatuar publikisht. Nëse këta dy persona qenkan aq të zotë, pse atëherë nuk janë bërë ministra në Qeverinë e Kosovës kur Kosova ka aq shumë nevojë për kapacitete të tilla! Genc

Cakaj nuk mund të llogaritet viktimitë e as i manipuluar por, thjesht, lakmia ia mundi prandaj, në moshë aq të re ka shfaqur ambicie karrieriste duke pranuar edhe korrigjimin e kufijve për këtë edhe është propozuar nga Baton Haxhiu i cili, me harta në duar, si Magelani dhe Amerigo Vespuqi, po tregon kufij të rinj të Kosovës për mbrojtjen e të cilëve nuk e ka derdhur as edhe një pikë djersë! Edi Rama i ka borxh Kosovës, Shqipërisë dhe të gjithë shqiptarëve që po e përkrah lojën e rrezikshme të Thaçit për korrigjim të kufijve, madje po bëhet edhe promotor i këtij preludi për një luftë të re në Kosovë dhe Ballkan! Edi Rama ka deklaruar se do të vazhdojë këtë përvojë me emërimin e ministrave në Qeverinë e Shqipërisë nga vendet e tjera dhe mos u habitni nëse nesër Ivica Daçiçin e propozon ministër të Brendshëm të Shqipërisë. Genc Cakaj u bë marionetë e Batonit dhe Hashimit, personave më të rrezikshëm dhe më të dëmshëm sot në Kosovë! Prandaj, e mori atë që e ka merituar, e përdorën dhe e hodhën aty ku e ka vendin! Nuk e kuptoj me çfarë të drejte kosovarët që kanë hequr dorë nga identiteti kombëtar shqiptar e urdhërojnë presidentin Meta të dekretojë ministra sipas parimit posta e porositur!

Argumenti kundër Besa Shahinit, se qenka mbesa e ish-udbashit, Ibush Kllokoqit, për mua është i ulët dhe i papranueshëm për faktin se Besa Shahini nuk ka përgjegjësi (kurrfare) për veprimet antikombëtare, kriminale dhe krimet e shumta që i ka bërë Ibush Kllokoqi ndaj veprimtarëve politikë dhe kombëtarë në Kosovë. Nëse Besa Shahini do t'i mbronte krimet e Ibush Kllokoqit, udbash kriminel, atëherë do të kishim tjetër situatë. Me një fjalë, secili e bartë kryqin e veprimeve që i ka bërë dhe përgjegjësia për krime nuk është se i lihet dikujt si trashëgimi. Duhet qartë të bëjmë pre-rjen midis kriminelit dhe atij që është në lidhje familjare me kriminelin, por se nuk shkon hapave të tij. Në fund të fundit, çka janë më të mirë disa këshilltarë të presidentit Thaçi dhe udhëheqësve të tjerë, se Besa Shahini?! Janë më të këqij, shumë më të këqij!

Nuk pajtohem, gjithashtu, se Baton Haxhiu të quhet spiun

dhe bashkëpunëtor i UDB-së sepse për këtë nuk ka fakte të mjaftueshme. Do të thosha që Batoni e ka një të kaluar të pasqaruar që lë dyshime të shumta për të, prandaj është dashur të miratohet Ligji për Lustracion të figurave publike. Një takim me Stanishiqin nuk është rast i vetëm kur dikush është takuar me pushtetarët serbë! Sot keni bashkëpunëtorë të Arkanit e që janë në poste të larta në sferën më të ndjeshme, atë të sigurisë. Është fakt se Batoni ka notuar mirë dhe me sukses në të gjitha regjimet dhe përfitimet eventuale që mund t'i ketë fituar nga Stanishiqi (nuk kam fakte) janë të papërfillshme përballë përfitimeve që i ka fituar nga Thaçi, Rama dhe biznesmenët tajkunë dhe të pamoralshëm në Kosovë dhe Shqipëri. Dhe, nuk është i vetmi.

Nuk pajtohem që as presidenti Hashim Thaçi të quhet kriminel sepse nuk kemi asnjë vendim gjyqësor në Kosovë dhe në ndonjë shtet tjetër të botës që e dëshmon këtë. Pajtohem se është i dëmshëm dhe paraqet rrezik politik për Kosovën, por edhe këtu mund të gaboj. Çka nëse Hashim Thaçi e merr krejt Luginën e Preshevës dhe nuk i jep asgjë Serbisë. Ku do të mbetemi në atëherë?! Ndoshta Hashim Thaçi ka vendosur t'i bashkojë të gjitha tokat shqiptare, Nishin, Luginën, Manastirin, Ohrin, Çamërinë, Ulqinin, Plavën e Gucinë, pjesën shqiptare të Maqedonisë, pjesën ilire të Italisë dhe Dalmacisë e mos të flasim për Çamërinë. Definitivisht, Hashim Thaçi është manipulues dhe shumë i dëmshëm. Atij nuk i interesojnë kufijtë e Kosovës, por i intereson kostumi që do ta veshë në

Uashington kur ëndërron ta nënshkruajë marrëveshjen me Vuçiqin, në prani të presidentit Tramp, i cili, në Amerikë, po hetohet për lidhjet e ngushta me Rusinë dhe Putinin. Hashim Thaçi është verbëruar nga shkëlqimi i reflektorëve dhe kamerave dhe fakti i të bërit pjesë e historisë edhe me çmimin se ia kanë nënën Kosovës nuk i bënë përshtypje fare. Për këtë e përdor si zëdhënës Baton Haxhiun, njeriun që nuk e do askush në Kosovë e as në Shqipëri, përveç Shkullakut dhe të ngjashmëve. Nuk është me rëndësi ku Hashim Thaçi e nënshkruan marrëveshjen, por përmbajtja e marrëveshjes së nënshkruar dhe një marrëveshje e mirë për Kosovën nuk mund të nënshkruhet me Vuçiqin, qoftë edhe në Garden Roses dhe në prani të Trampit, nëse deri atëherë do të jetë në pushtet!

Nuk mund ta quaj gomar as Edi Ramën siç e bëjnë disa sepse, edhe nëse ka sjellje të ngjashme me këtë krijesë të Zotit, fizionimia dhe anatomia i dallon shumë.

Nuk gëzohem dhe nuk kërkoj që Hashim Thaçi të burgoset dhe të dërgohet në Hagë përkatësisht në Gjykatën Speciale sepse është jonjerëzore dhe e pamoralshme që ta ndërtohet lumturinë mbi fatkeqësinë apo tragjedinë e tjetrit aq më parë që të tjerët e vendosin se kush, ku do të shkojë sikur që jam kundër çdo denigrimi të personalitetit përmes fyerjeve dhe akuzave të paargumentuara. Në fund, mund edhe t'i ikim drejtësisë tokësore, por asnjëherë dhe kurrë asaj, drejtësisë hyjnore. I kemi shembujt e freskët: Millosheviqi, Gadafi, Sadati dhe shumë të tjerë!



## Kosova hap ambasadën në Portugali

**PRISHTINË, 11 JANAR (ER)** - Kosova për herë të parë ka hapur ambasadën në Portugali. Kështu është bërë një shtrirje e re diplomatike në Evropë, në një shtet i cili është anëtar i NATO-s dhe Bashkimit Evropian. Me anë të një ceremonie zyrtare nga shteti pritës u akreditua edhe zyrtarisht, ambasadori i parë i Republikës së Kosovës në shtetin portugez, Ylber Kryeziu, i cili ia ka dorëzuar

letrat kredenciale presidentit të Portugalisë, Marcelo Rebelo de Sousa. "Ambasadori Kryeziu i përcolli presidentit të këtij shteti de Sousa urimet e presidentit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, dhe përkushtimin institucional për thellimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të marrëdhënieve në mes dy vendeve dhe dy popujve", është thënë në komunikatën e Ambasadës së Kosovës në Portugali.

Republika e Kosovës ka vendosur të hapë për herë të parë Ambasadë në shtetin portugez gjatë vitit të kaluar, veprim ky që u mirëprit dhe vlerësua lart edhe nga autoritetet e shtetit pritës. Portugalia e kishte njohur Republikën e Kosovës pak muaj pas shpalljes së pavarësisë dhe në vazhdimësi ka ofruar mbështetje për konsolidimin e shtetit të ri dhe integrimin e tij në organizatat ndërkombëtare.

## LDK-ja bën homazhe te përmendorja e Enver Malokut

**PRISHTINË, 11 JANAR (ER)** - Kryesia e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) ka bërë homazhe të premtën te përmendorja e Enver Malokut në 20-vjetorin e vrasjes së tij. Delegacioni i Lidhjes Demokratike të Kosovës ishte i udhëhequr nga sekretari i përgjithshëm i kësaj partie, Ismet Beqiri, ku në emër të kryesisë së LDK-së kanë vendosur buqeta me lule te vendi i vrasjes së Malokut. "Enver Maloku është vrasë në pasditen e 11 janarit 1999 pak metra prej banesës së tij në lagjen Kodra e Diellit në Prishtinë. Vrasësit e tij kurrë nuk janë arrestuar dhe vënë para drejtësisë", është thënë në komunikatën e LDK-së.



## ShBA-ja nis tërheqjen e trupave nga Siria

WASHINGTON, 11 JANAR - Koalicioni i udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara në Siri ka filluar të largojë trupat nga vendi.

"Kemi nisur procesin e tërheqjes së planifikuar nga Siria", tha koloneli Sean Ryan, një zëdhënës i koalicionit amerikan i angazhuar në luftën kundër grupit të Shtetit Islamik.

"Për shkak të shqetësimit për sigurinë operacionale, nuk do të diskutojmë afate specifike,

vendndodhje apo rreth lëvizjes së trupave", tha ai.

Më parë këtë javë, këshilltari për Sigurinë Kombëtare Jon Bolton bëri thirrje për mbrojtjen e milicisë së kurdëve të Sirisë, YPG-në si parakusht për tërheqjen e trupave amerikane nga vendi. Deklarata shkaktoi zemërimin e presidentin turk Rexhep Tajip Erdogan dhe si pasojë ai refuzoi të takohej me zyrtarin amerikan.

YPG-ja është një aleat i rëndë-

sishëm në luftën e Uashingtonit kundër Shtetit Islamik, por Ankaraja e konsideron atë si një grup terrorist, i lidhur me një përpjekjet për rebelim brenda Turqisë.

Trupat amerikane u përfshinë në luftën e Sirisë në vitin 2014, kohë kur në këtë vend mbërriti divizioni i parë elitë me detyrën për t'i këshilluar luftëtarët e udhëhequr nga kurdët, të përfshirë në përpjekjet kundër grupit të Shtetit Islamik.



## Greçia i kërkon Gjermanisë kompensimin e dëmeve të luftës

Presidenti i Greqisë Prokopis Pavlopoulos gjatë një takimi të premtën me kancelaren Angela Merkel e ngriti sërish kërkesën e zhdëmtimit prej miliarda eurosh për pushtimin nazist të vendit gjatë Luftës së Dytë Botërore. Gjermania në të kaluarën i ka refuzuar kërkesat e tilla të Athinës



tuquajturi "borxh i pushtimit" për të financuar fushatën naziste në Afrikën e Veriut.

Në atë kohë, Greçia u detyrua të dorëzojë mbi 476 milionë marka, shumë e cila vlerësohet

tashmë nga zyrtarët grekë të jetë në vlerën e rreth 69 miliardë dollarëve.

ATHINË, 11 JANAR - Greçia i tha të premtën kancelares gjermane Angela Merkel se ka baza për të ngritur kërkesën e zhdëmtimit prej miliarda eurosh për pushtimin nazist të vendit gjatë Luftës së Dytë Botërore. Përveç dëmeve gjatë pushtimit nazist në vitet 1941-1944, në atë periudhë Gjermania mori me forcë nga buxheti grek të ashtuquajturin "borxh të luftës", për të financuar fushatën ushtarake në Afrikën e Veriut.

Gjermania i ka refuzuar kërkesat e Athinës në të kaluarën, por presidenti grek e ngriti çështjen sërish gjatë një takimi me kancelaren Merkel, e cila po zhvillon një vizitë dyditore në Greçi.

"Ruaj qëndrimin e Greqisë, të cilin ju e dini, për sa i përket borxheve të pushtimit dhe zhdëmtimit për krimet e pushtimit nazist në Greçi. Ne i konsiderojmë këto kërkesa ligjërish aktive dhe që mund të shqyrtohen në sistemin gjyqësor dhe që duhet të zgjidhen në një forum kompetent evropian, në një forum gjyqësor ose ekonomik, bazuar në kulturën ligjore ndërkombëtare dhe evropiane", deklaroi presidenti i Greqisë, Prokopis

Pavlopoulos.

Çështja e zhdëmtimit për Luftën e Dytë Botërore u rishfaq si një çështje emocionale gjatë krizës së borxhit të Greqisë, ku u rikthyen në vëmendje padrejtësitë e së shkuarës dhe u fajësua kreditorja më e madhe, Gjermania, për shkurtimet e dhimbshme buxhetore.

"Më duhet të them se jemi të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë tonë historike. E dimë se sa vuajtje Gjermania i shkaktoi Greqisë gjatë epokës së nacional-socializmit. Leksioni për ne është që të bëjmë gjithçka të mundur për marrëdhënie të mira me Greqinë dhe për të mbështetur njëri-tjetrin. Sigurisht që njerëzit po kalojnë kohë shumë të vështira dhe shpresojmë që rritja ekonomike, që tashmë është sërish e pranishme, do të ketë ndikimin e saj te të gjithë qytetarët e këtij vendi", tha kancelarja gjermane.

Në të kaluarën, Gjermania ka kërkuar ndjesë për krimet e nazizmit, por ka mohuar se i ka detyrime të mëtejshme Greqisë, pasi i pagoi Athinës në vitin 1960 rreth 115 milionë marka gjermane. Gjatë pushtimit hitlerian të Greqisë në periudhën 1941-1944, u mor edhe i ash-

## Rusia dënon planet e Britanisë për baza të reja ushtarake

MOSKË, 11 JANAR - Moska dënon planet e Britanisë për të ndërtuar baza të reja ushtarake në juglindje të Azisë dhe Karaibe, duke thënë se Rusia është e gatshme për masa hakmarrëse nëse kërcënohen interesat e saj ose të aleatëve të saj.

Ministri i Brendshëm britanik, Gavin Williamson, ka thënë se Britania mund të ndërtojë baza të reja ushtarake "brenda pak vitesh", pasi ky vend të dalë nga



Bashkimi Evropian. Williamson ka thënë se zgjerimi do të ishte pjesë e një strategjie të Britanisë për t'u bërë një lojtar

i vërtetë global pas Brexit-it. Ai nuk e ka specifikuar se ku mund të ndërtohen këto baza. Duke folur të premtën, zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme ruse, Maria Zakharova, tha se planet janë misterioze dhe paralajmëroi se ato mund t'i destabilizojnë çështjet botërore. Rusia ka baza ushtarake në disa ish-vende sovjetike. Ajo, po ashtu, operon me objekte ushtarake në Siri dhe Vietnam.

## Macroni anulon Forumin e Davosit

Paris, 11 janar - Emmanuel Macron nuk do të jetë i pranishëm në Forumin e Davosit, ku merr pjesë elita e ekonomisë botërore, por do të mbledhë më 21 janar në Versajë 150 biznesmenë francezë dhe të huaj, për një edicion të ri të samitit "Zgjidhni Francën" mbi fuqinë tërheqëse franceze, njoftoi të premtën Elysee.

Megjithëse kreu i shtetit mbajti një

fjalim të gjatë në Forumin e Davosit vitin e kaluar, presidentët francezë nuk marrin pjesë sistematikisht në këtë takim në Zvicër, i cili do të zhvillohet këtë vit nga 21 deri në 25 janar.

"Emmanuel Macroni nuk do të marrë pjesë në takim për shkak të një agjende të zënë", thekson Elysee.

"Me pjesëmarrjen e 150 biznes-

menëve në Versajë, vullneti ynë është t'i nxjerrim në pah mundësitë në vend duke bërë të njohur rajonet e ndryshme dhe njohuritë rreth tyre. Në takim do të jenë gjithashtu të pranishëm edhe kompani franceze të dimensioneve të ndryshme, që përfaqësojnë strukturën ekonomike në rajon", thuhet në njoftimin e Elysee.





# BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



**E jashtëzakonshme**

## Lind viçi me një sy, adhurohet në Indi

Një viç i porsalindur me vetëm një sy është adhuruar si një perëndi në Indinë lindore. Viçi i vogël, pamja e të cilit është për shkak të një defekti të lindjes, lindi në lagjen Bardhaman të Bengalit Perëndimor në Indi.



**FOTO E DITES**



Një burrë në Kabul shtyn një karrocë me disa bidon në borë. /AFP/

**E rrallë**

## Shiti veshkën për të blerë 'iPhone'dhe 'iPad'

Një 25-vjeçar ka shitur njëren prej veshkave në tregun e zi për të blerë një 'iPhone' dhe 'iPad' të ri, ndërkaq tani ka mbetur me aftësi të kufizuara. I riu nga Kina nuk lëviz dot nga krevati dhe kërkon kujdes të vazhdueshëm.



**BARSOLETA E DITËS**



**Burri i thotë gruas: Nëse s'do të kisha ty do të humbisja.**

**Gruaja: Kaq shumë më dashuron?**

**Burri: Jo aq, por nuk e di rrugën për në shtëpi.**



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Në ora 16:00**

### "THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



**Në ora 17:30**

### "THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston



**Në ora 19:30**

### "MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Rafferty, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers



**Në ora 22:00**

### "HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Sot do ta keni mundësinë t'i analizoni mirë ngjarjet që po ndodhin rreth jush. Paraqitet një ditë e qetë dhe pa shumë aktivitet.</p>	 <p><b>DEMI</b> Në ambientin e punës jo çdo gjë po shkon siç duhet. Kjo do t'ju zgjojë dëshirën të ktheheni sa më shpejt pranë familjes.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Edhe puna edhe shoqëria sot do të kenë rol të rëndësishëm në jetën tuaj. Do të dini t'i ekuilibroni situatat midis dy fushave.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Jeni të bindur në një vendim tuajin dhe nuk ekziston asnjë mundësi që t'ju kthejë mendjen. Megjithëse do të keni pengesa, do të dini të ecni përpara.</p>	 <p><b>LUANI</b> Është mirë të ndryshoni ambient sot sepse duke u larguar do të jeni më të kthjellët dhe do t'i vlerësoni më drejt situatat e ndryshme.</p>	 <p><b>VIRGJËRËSHA</b> Sot jeni në kundërshtim me këndvështrimin e kujt do që keni pranë. Do të ketë debate të ashpra midis jush dhe një të linduri të Peshores.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Jeni vëzhgues të mençur dhe sigurisht kjo gjë ju favorizon në shumë situata. Sot mendoni vetëm se si të relaksoheni.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Sot nuk duhet të ekzagjeroni në kërkesa. Jo të gjitha gjërat që kërkonit mund të kenë kushte për t'u realizuar.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Mos kërkonit aventura sot sepse nuk do të mund ta përballonit dot rezikun. Një sekret i kohëve më parë do t'ju shqetësojë.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Indiferenca në shumë raste është arma më e mirë për të mos vuajtur. Jeta na rezervon çaste të dhimbshme që mund të na lëndojnë.</p>	 <p><b>UJORI</b> Konsideroni atë që ju thotë instinkti juaj i pagabueshëm sot. Mund të jetë çasti për një ndryshim të madh dhe total në jetën tuaj.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Doni ta filloni sa më shpejt ditën dhe do të niseni në një udhëtim që keni kohë që e keni prenotuar. Do të relaksoheni në shoqëri të mirë.</p>

## Brad Pitti nuk mund t'i takojë fëmijët pas divorcit



**A**ngelina Jolie dhe Brad Pitti tashmë ka kohë që janë shkukurëzuar edhe përmes proceseve gjyqësore. Megjithëse janë marrë vesh edhe sa i përket kujdestarisë së fëmijëve, duket se një gjë e tillë nuk po ndodh në jetën e përditshme. Shkak është bërë fakti që aktorja ka zgjedhur që fëmijët të dilnin për të bërë pazar

të shoqëruar nga një truprojë, ndërkohë që këtë punë fare mirë mund ta bënte babai i tyre. "Ai është i mërztur që nuk mund të ketë një rol më të madh në rritjen e fëmijëve dhe nuk i pëlqen që fëmijët të kalojnë shumë kohë me truprojat dhe asistentët e Joliet dhe që nuk i takon", ka pohuar një burim për mediet amerikane.

## Demi Rose në Meksikë, e gjithë vëmendja tek ajo



**D**emi Rose është sërish në qendër të vëmendjes. Bukuroshja 23-vjeçarja tregoi format e saj dje në

Meksikë. Ylli ishte veshur me bikini të zeza dhe dukej e mrekullueshme. Dhe, sigurisht, të gjithë sytë ishte te Demi.



## Cardi B shijon pushimin

**R**eperja amerikane Cardi B së fundi ka shpërndarë një fotografi në rrjetet sociale. Në atë fotografi ajo shihet duke

pushuar në një ulëse dhe duke pirë kafe. Në mbishkrimin e fotografisë ajo tregon se rrobat që ka të veshura janë të brendit "Dolce Gabbana".



## Camila ia kalon Adeles

**C**amila Cabello është mbretëresha e re e muzikës më të dëgjuar. Hiti i 21-vjeçarës "Havana" është bërë kënga më e dëgjuar online e të gjitha kohëve nga një artiste femër. Tani "Havana" numëron mbi 3.4 miliardë dëgjues,

duke e mundur këngën "Hello" të Adeles, e cila kishte 3.36 miliardë. Kujtojmë se Camila është nominuar për dy çmime në ceremoninë e ardhshme të Grammy Awardsit. Kjo ceremoni pritet të mbahet në muajin e ardhshëm.

# 'Bardhësitë e atdheut', libri më universal, gjithëpërfshirës dhe më i kompletuar për heronjtë dhe sakrificat e atdheut

*Libri enciklopedik "Bardhësitë e Atdheut" i publicistit Afrim Mustafa shtjellon fakte të shumta, pasqyron ngjarje dhe luftën e UÇK-së të cilat, edhe nëse i kemi dëgjuar, kujtesa e shoqërisë nuk i ka arritur t'i mbajë të gjitha në mend, andaj duke shfletuar këtë libër i rikujtojmë ngjarjet e mëdha, e duke rikujtuar nuk i harrojmë ato sakrifica dhe ato flijime për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës... Jo vetëm për nga volumi, por më shumë për nga përmbajtja mbetet libri më i kompletuar i kësaj natyre, i botuar deri më tani në Kosovë dhe në trojet shqiptare. Prandaj, vetëm me një përkushtim të kësaj natyre dëshmohet e vërteta e luftës së lavdishme të UÇK-së, UÇPMB-së dhe UÇK-së... Regjistrimi kaq i kujdesshëm për të rënë në luftën e Kosovës, por edhe për dy luftërat e tjera, është një respekt i drejtpërdrejtë për këto luftëra, ku vetë autori ishte pjesëmarrës, është nderim dhe respekt për heronjtë dhe dëshmorët, si dhe të rënë të tjerë, por më shumë është një respekt për lirinë, për të tashmen dhe për ardhmërinë e këtij vendi...*

## Shkruan: Shefqet DIBRANI

Vepra: "Bardhësitë e Atdheut", është radhitur si libër enciklopedik me rëndësi kapitale për autorin, për shoqërinë dhe për historiografinë e Kosovës. Afrim Mustafa, shquhet si mbledhës i kujdesshëm i shënimeve për dëshmoret dhe të rënë në luftë, kurse libri është dëshmi e luftës së Kosovës dhe luftërave të tjera në hapësirën shqiptare në Ballkan. Libri "Bardhësitë e Atdheut" është ribotuar disa herë, (shqyrtimi ynë ka të bëjë me një botim të vitit 2014), por secili botim i mëvonshëm është plotësuar dhe është zgjeruar me portrete dhe të dhëna të reja për dëshmorët dhe heronjtë e Kosovës, duke e bërë librin një Enciklopedi e sojtit të vet, një përkushtim i rrallë për t'i publikuar të gjithë dëshmorët, heronjtë dhe veteranë e luftëtarë të Luftës së Kosovës 1998-1999. Autori, është përkujdesur në aspektin profesional për të angazhuar emra të njohur të luftës, shkencës dhe fesë, me të cilët ka krijuar stafin e librit, një vlerë tjetër universale, e cila

bartet edhe në brendësinë e librit. Në mesin e këtij stafi, janë: Dr. Jakup Krasniqi, Akad. Esat Stavileci, Akad. Pajazit Nushi, Dr. Don Lush Gjergji, Gjeneral, Kudusi Lama, Dr. Jahja Drançolli, dr. Teuta Hadri, Mr. Naim Tërnavë etj. Ndërsa, diku në brendësi në një faqe të plotë

është "Ekipi këshillëdhënës i monografisë", që kanë ndihmuar autorin për mbledhjen e të dhënave, duke i falënderuar ata publikisht, e për vete autori ka dëshmuar vlerë intelektuale dhe qasje humane. Libri "Bardhësitë e Atdheut", hapet me Tri emblemat e UÇK-së, të shoqëruara me tekstin e Betimit, të cilin e ka bërë ushtari në luftë. Pastaj, është fjala e kryerrecensentit, dr. Jakup Krasniqi, atëherë, kryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës, e në vazhdim, janë prezantuar: Adem Jashari, Zahir Pajaziti, Agim Ramadani, Adrian Krasniqi, Xheve e Fehmi Lladroci, Ismet Jashari, Mujë Krasniqi, Ilaz kodra, Halit Geci, Gursel e Bajram Sylejmani, Salih Çekaj, Ilir Konushevc, Gjylsere Saiti, Bekim Berisha, Hyrë Emini, e shumë të tjerë. Në parathënieën e shkruar nga vetë autori, ai ka vlerësuar kontributin e secilit intelektual, luftëtar dhe veprimtar për kauzën kombëtare, duke ua përmendur meritat, gjithsecilit. Këtë vlerësim, autori e ka bërë edhe për Presidentin Historik: dr. Ibrahim Rugova, për të cilin shkruan: "Pa mëdyshje, një nderim të jashtëzakonshëm me veprimet e tij madhore e thellë përkushtuese për Kosovën, për lirinë dhe për pavarësinë e saj dhe për gjithë Shqiptarinë, na

dha deri në fund të Jetës së tij, presidenti Historik i Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova (1944 - 21 janar 2006). Rugova, ky binom i të mirave kombëtare, e veçanshëm kontribuues dhe ndërtues unikat i lirisë së Republikës së Kosovës, do të kujtohet e nderohet përjetë e mot, bashkë me të gjithë ata që dhanë edhe jetën për ditët që sot i jetojmë. Emri dhe vepra e presidentit historik janë frymëzim dhe sinonim i unitetit të veçantë e të jashtëzakonshëm, që reflektoi ai në jetë, në veprim e në punë për liri, pavarësi e sovranitet gjithëkombëtar...". Po me këtë elan, po me këtë përkushtim, ua përmend meritat edhe prof. dr. Fehmi Aganit, Anton Çettës, Ali Hadrit, Zekiria Canës, Gazmend Zajmit, si dhe ka shkruar për dhjetëra femra-dëshmore të UÇK-së, duke radhitur më pas, personalitete të shquara ndërkombëtare, të cilat kanë dhënë kontribut për lirinë e Kosovës, siç janë: Presidenti Amerikan Bill Clinton, bashkë me Hillari Clinton, Medlin Olbrajt, Wsli Clark, Riçard Hollbruk, Gjorgj Robertson, Xhemi Shea, Barak Obama, Toni Bler, Zhak Shirak, Viliam Valker, Angela Merkel e shumë të tjerë, të cilët kompletojnë më mirë angazhimin e secilit prej tyre për pavarësinë e Kosovës.



## "Bardhësitë"... pasqyrë e atdhedashurisë

Në libër ka shënime të tjera për personalitete me ndikim, qoftë në aspektin humanitar e liturgjik siç është Nënë Tereza, por autori nuk ka ngurruar t'i citojë dhe përmendë të gjithë shqiptarët, që kanë ndikuar në imazhin pozitiv për Kosovën, siç janë sportistë e artistë të ndryshëm, këngëtarë e krijues artesh. të cilëve u janë theksuar meritat për përhapje të imazhit pozitiv për Kosovën. Natyrisht, kjo dyndje kaq e madhe, nuk ka kaluar pa shumë vështirësi e sakrifica, por qëllimi i autorit duket i qartë, ai mbron idenë për të ndërtuar konceptin e librit, duke e prezantuar sa ma mirë kontributin e secilit, sepse për të ardhur Vendi Ynë deri këtu, është dashur angazhim i secilit, andaj autori ka bërë përpjekje që t'i ketë të gjithë brenda librit të tij. Një pjesë e madhe e kësaj enciklopedie u kushtohet dëshmorëve, heronjve, dhe luftëtarëve, prezantimet e tyre i nënshtrohen kriterit të alfabetit, për të cilët autori ka bërë edhe shënime biografike, të cilat janë shoqëruar edhe me fotografitë e protagonistëve. Me të njëjtën metodologji, autori ka vepruar edhe me dëshmorët dhe martirët e UÇPMB-së për Kosovën Lindore dhe të rënë në Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare. Afrim Mustafa ka publikuar një listë me Dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku ka dhënë edhe një shpjegim se, lista nuk është përfundimtare, për të cilën ka shkruar se do të ndryshohet, do të shtohet dhe do të plotësohet nga botimi në botim. Në këtë kapitull, është publikuar edhe lista e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, si dhe për Dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, në trevën e Maqedonisë, si dhe një listë dhe fotografi, ku i ka prezantuar edhe 71 dëshmorë e luftëtarë nga Shqipëria, të cilët kanë qenë të angazhuar në luftërat e shqiptarëve për pavarësi, si dhe një listë e grave dhe vajzave shqiptare, të cilat,





### *Enciklopedia e Afrim Mustafës - qasja dhe përpjekja më reale e një autori për ta prezantuar luftën pa anime politike dhe pa ndikime rajonale...*

janë dëshmore të lirisë së Kosovës. "Bardhësitë e Atdheut", është libri më universal, më gjithëpërfshirës dhe më i kompletuar që është botuar deri më tani. Aty, janë prezantuar protagonistët kryesorë të luftës, secili në kohën e vet, dhe secili në betejën e caktuar. Siç duket, Autori, nuk ka bërë ndarje, aq më pak anatemi për të rënë për lirinë e atdheut. Të gjithë ata që janë flijuar dhe kanë kontribuar për luftën, kanë zënë vend brenda Enciklopedisë "Bardhësitë e Atdheut", me autor, Afrim Mustafa. Brenda librit, Afrim Mustafa, ka botuar, reportazhe, portrete dhe raporte nga fronti i luftës, nga tubime e manifestime të shumta, nga përvjetorë të caktuar, si dhe shumë mendime - recensionet për librin "Bardhësitë..."

#### **"Bardhësitë e atdheut", përjetësim i heroit, ringjallje e kujtesës, faktit dhe dëshmisë së lavdisë...**

Padyshim, Afrim Mustafa, ka punuar pareshur, për ta kompletuar sa ma mirë veprën, e cila jo vetëm për kah volumi, por më shumë për kah përmbajtja mbetet libri më i kompletuar i kësaj natyre, i botuar deri më tani në Kosovë dhe më gjerë. Prandaj, mendojmë se, vetëm me një përkushtim të kësaj natyre mund të dëshmohet e vërteta, dhe autori ka kurorëzuar me sukses veprën e tij, e cila do të rrojë dhe do të dëshmojë edhe atëherë kur vet autori nuk do të jetë në mesin e të gjallëve ... Përfshirja e portretit të Afrim Zhitisë, Jusuf e Bardhosh Gërvallës, Kadri Zekës, Rexhep Malës, Nuhi Berishës dhe të tjerëve, e bën lidhjen e një vazhdimësie të përpjekjeve për liri e pavarësi, që e kanë bërë breza të shumtë shqiptarësh,

sikurse prezantimi i klerit mysliman dhe atij katolik e kompletton edhe më tej konceptin e Enciklopedisë, brenda së cilës krijohet përshtypja se është "Një Kosovë e Vogël". Aty janë përfshirë, gazetarë, rapsodë, veprimtarë dhe mërgimtarë, si dhe qytetarë të tjerë, të cilët me angazhimin e tyre, me dijen e tyre kanë dhënë shumë për vendin, shoqërinë dhe njerëzimin, në mesin e të cilëve janë prezantuar: Afrim Maliqi, Haki Braha, intelektualë e shkrimtarë, si Fehmi Agani, Latif Berisha, Ymer Elshani, Bardhyl Çausi, Bajram Kelmendi me fëmijët e tij etj. Kësaj enciklopedie ia shton vlerën edhe lista e dëshmorëve të Kosovës, të rënë mes viteve 1964-1992, të cilët autori i kategorizon. 1. Të vrarë me atentat, 2. Të vrarë në luftim, 3. Veprimtarë të mbytur në burg, 4. Të vrarë në demonstrata, e më pas, është publikuar edhe Lista e 114 dëshmorëve të rënë në Betejën e Kosharës, si dhe lista të tjera, statistika të shumta dhe fakte që tronditin secilin lexues, sidomos prekin ndjenjën e atyre që luftën e mbijetuan me sakrificë të shumta. Afrim Mustafa, me këtë veper të përmasave enciklopedike, ka arritur të bëhet emër më i dashur, sepse t'i publikosh ngjarjet, të cilat i ka sistemuar në këtë Libër është një përjetësim i heroit, është një ringjallje e faktit dhe dëshmisë, por më shumë ringjallje e kujtesës për dëshmorin, a heroin që u flijua për lirinë. Kjo që theksuam, është një karakteristikë e rrallë, vlerë kjo që do të mbetet përgjithmonë, prandaj regjistrimi kaq i kujdesshëm për të rënë në Luftën e Kosovës, është një respekt i drejtpërdrejt për atë luftë, ku vet autori ishte pjesëmarrës, është nderim e respekt për heronjtë dhe dëshmorët, si

dhe të rënë të tjerë, por më shumë është një respekt për lirinë, për të tashmen dhe për ardhmërinë e këtij vendi.

Autori, duke qenë reporter i drejtpërdrejtë i luftës së UÇK-së, dhe duke kryer gjatë asaj lufte punë me rëndësi të veçantë, substanca e prezantuar në libër është koncept i asaj kohe, kur nuk dihej kush fiton, e kush shpëton, por si koncept mjaft i kompletuar dhe si mënyrë tejet fisnike. Afrim Mustafa, është ndër personalitetet e pakta, i cili zhvillimet e luftës nuk i sheh të ndara, ai në enciklopedinë e tij i ka përfshirë të gjithë dhe të gjitha kategoritë, libri shënon hapin konkret profesional për t'i përfshirë të gjithë dëshmorët e të tri luftërave të UÇK-së, sepse ideali i tyre, ishte liria e atdheut dhe përparimi i vendit. Në këtë pikë, Afrim Mustafa e ka përmbushur misionin e tij të luftëtarit për t'ia sjellë Kosovës lirinë, kurse me misionin e gazetarit, sikur ka dhënë mesazh për t'u afruar edhe në fushat e tjera të përbashkëta.

Përveç figurave të rëndësishme komanduese e udhëheqëse të luftës, Afrim Mustafa ka publikuar edhe një listë me ushtarët shqiptarë të vrarë në Armatën Jugosllave në mes të viteve 1981-1992. Në Enciklopedi, janë publikuar portrete me emrat e dëshmorëve, duke i formuar listat sipas rretheve e regjioneve dhe komunave të caktuara, por autori në enciklopedinë "Bardhësitë e Atdheut", ka arritur t'i përfshijë, pothuajse të gjithë dëshmorët e rënë heroikisht në luftë: UÇK në Kosovë, UÇPMB në Kosovën Lindore dhe UÇK në Maqedoni. Në këtë enciklopedi janë prezantuar dhjetëra-mijëra dokumente, dëshmi e fakte të rëndësishme për historiografinë kombëtare, duke filluar nga vitet 1900 e gjerë në vitin 2002. Me këtë veper, autori ka treguar se, Lufta e Kosovës ishte vazhdimësi e përpjekjeve shekullore të shqiptarëve për lirinë e vendit, për të cilën janë sakrifikuar breza të tërë shqiptarësh, prandaj janë përfshirë edhe figura të rëndësishme

të viteve 1943-1945, pastaj të viteve: 1968, 1981, 1989 etj. Pra, nga Shaban Polluzha e Mulla Idriz Gjilani te Fazli Graiçevci, nga Jusuf e Bardhosh Gërvalla me Kadri Zekën te Afrim Zhitia, Fahri Fazliu e Ylfete Humolli etj. dhe kjo nuk mund të jetë vetëm rastësi!

Por, siç e mban edhe titullin, enciklopedia i kushtohet luftës së UÇK-së, në qendër të trajtimit janë: Adem, Shaban e Hamzë Jashari, Zahir Pajaziti, Agim Ramadanin e Salih Çekaj, Ilaz Kodra, Fehmi e Xhevë LLadrovci, vëllezërit: Gursel e Bajram Sylejmani etj; por edhe dr. Ibrahim Rugova, Fehmi Agani, Anton Çetta, Latif Berisha, Bajram Kelmendi dhe personalitetet të tjera, të cilat bëhen pjesë e "Bardhësisë intelektuale!"

Në enciklopedinë "Bardhësitë e Atdheut", janë përfshirë edhe dëshmorë të veçantë, siç janë shqiptaro-amerikanët, përkatësisht, vëllezërit: Mehmet, Agron dhe Yll Bytyçi, si dhe disa dëshmorë nga shtetet e huaja: Algjeriani, Murad Muhamed Ali, francezi, Arnaud Pierre Paillard dhe italianin, Françesko Bider Biella. Libri enciklopedik "Bardhësitë e Atdheut", me autor, Afrim Mustafa, përmbillet me fotografitë dhe shënimet për 45 presidentët amerikanë, që nga Xhorxh Washington e deri te presidenti aktual, Donald Trump. Shikuar në përgjithësi, enciklopedia e Afrim Mustafës, është qasja dhe përpjekja më reale e një autori, për ta prezantuar luftën pa anime politike dhe pa ndikime rajonale. Kjo veper e bën Afrim Mustafën gjurmues dhe hulumtues të zellshëm, kryesisht i pasionuar pas të vërtetës dhe realitetit që ka ndodhur në rrethana të caktuara. Ai, duke shfrytëzuar burime të shumta dhe të ndryshme e ka bërë faktin më të besueshëm, kurse qasjen e trajtimit, mjaft serioze.

Sigurisht, pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e autorit në luftë ka ndikuar edhe në konceptin e Enciklopedisë, e cila si e tillë është libër mjaft i kompletuar.

Këto gjurmime dhe hulumtime i bëjnë secilit nder, sepse mbledhja dhe publikimi i gjithë këtyre të dhënave brenda një libri, jo vetëm për dëshmorët e rënë për liri, por u ka bërë një nder të veçantë familjeve dhe familjarëve të tyre, duke i dhënë dimension më universal veprës "Bardhësitë e Atdheut"... Andaj, do të ishte mirë, sikur institucionet e Kosovës ta ndihmojnë autorin, në mënyrë që enciklopedia edhe në aspektin teknik, të ketë parametra të lartë dhe libri, gjithsesi, të botohet me ngjyra... Në këtë mënyrë, rritet vlera artistike e veprës në njërin anë, kurse në anën tjetër tregohet edhe përkushtimi i shoqërisë për dëshmorët, sepse autori (edhe kështu siç është ky libër), e ka kryer misionin e tij në raport me ATA, që na sollën lirinë!

### **Autori, i pasionuar pas të vërtetës dhe realitetit që ka ndodhur në rrethana të caktuara...**

Brenda, "Bardhësisë së Atdheut", janë prezantuar dëshmi e fotografi për masakrat e terrorit serb, në fshatrat Reçak, Abri, Stagovë, Izbicë, Rakoc, Lybeniq, Suharekë, Kotlinë, Llashticë, si dhe në Sllupçan të Kumanovë, në maj të vitit 2001. Gjithsesi, libri enciklopedik, "Bardhësitë e Atdheut" i Afrim Mustafës, shtjellon fakte të shumta, pasqyron ngjarje dhe luftën e UÇK-së, të cilat edhe nëse i kemi dëgjuar, memoria e shoqërisë nuk i ka arritur t'i mbajë të gjitha në mend, andaj duke shfletuar këtë libër, i rikujtojmë ngjarjet e mëdha, e duke rikujtuar nuk i harrojmë ato sakrificat dhe ato flijime për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës...

Libri, "Bardhësitë e Atdheut", i Afrim Mustafës, mund të trajtohet edhe në dimension të tjera, sigurisht këtë do ta bëjnë specialistë dhe kompetentë në fusha përkatëse. Por, Afrim Mustafa dhe shoqëria jonë kanë sfida të madha para vetës, për të vazhduar mbledhjen dhe sistemin, pse jo edhe publikimin e atyre të dhënave, që nuk janë prezantuar këtu dhe në botime të tjera të autorit, si dhe nëpër librat e kësaj natyre me autorë të tjerë. Këtë obligim karshi autorit, e kanë të gjithë qytetarët e Kosovës, të cilët dinë dhe kanë fakte të reja, duhet t'ia afrojnë autorit për t'i radhitur e sistemuar.

Mendoj se, po me këtë përkushtim ndaj luftës dhe të rënëve, duhet të paraqiten edhe përpunues teknikë të fotografive, në mënyrë që fytyra e luftëtarit dhe e dëshmorit të duket pasqyrë e tashmes dhe e lirisë së Kosovës, tamam ashtu siç ishte e pastër lufta e UÇK-së për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Autori, Afrim Mustafa, e ka përmbushur misionin e tij prej luftëtari, i cili në lirinë e Kosovës, historiografisë shqiptare ia dhuroi një veper me përmasa të një enciklopedie nacionale!...

St. Gallen, 17 dhjetor, 2018

# Zbuloni 10 arsye për të vizituar një muze

Një nga justifikimet më të shumta që përdoret për të mos vizituar institucionet e trashëgimisë kulturore është shpeshherë tarifa e hyrjes në këto institucione. Megjithatë, një studim i kryer nga Harris Interactive gjen se njerëzit janë më të lumtur kur shpenzojnë para për përvoja në vend të blerjeve materiale.

## 1. Muzetë të bëjnë të ndihesh mirë


Sipas Leaf Van Boven, Asistent Profesor i Psikologjisë në Universitetin e Kolorados, përvojat duket të krijojnë më shumë lumturi sesa objektet material, sepse ato sigurojnë ri-interpretime pozitive personale me kalimin e kohës. Domethënë, ndërsa rikujtojmë vizitën tonë në muze, ne kemi një tendencë për të pastruar psikologjikisht çdo kujtim negativ (nëse ka ndonjë). Përvojat, të tilla si vizitimi i një muzeu, gjithashtu mund të bëhen pjesë kuptimplote e identitetit shoqëror dhe të kontribuojnë në marrëdhëniet e suksesshme shoqërore në një mënyrë që sendet materiale nuk mundën. Pra, vizita në muze do t'ju bëjë më të lumtur në afat të gjatë.

## 2. Muzetë të bëjnë më të zgjuar

Roli kryesor i muzeve është përdorimi edukativ i komunitetit. Muzetë mund të bëhen frymëzues për studime në disa dhjetëra fusha akademike dhe mund të ndihmojnë gjatë studimeve. Në disa raste dhe vetë shkollat mbështeten të muzetë për hartimin e kurrikulave të tyre. Galeritë e artit gjithashtu po marrin dita-ditës formën e "sallave të studimit". Është e pamundur të vizitosh një muze e të mos dalësh me një informacion të shtuar në fund të vizitës.

## 3. Muzetë janë hapësira të dijes

Muzetë sot na paraqiten si



hapësira informale edukimi, të cilat ndihmojnë procesin e marrjes së dijes dhe edukimin e brezave, një proces i gjatë ku individët fitojnë qëndrime, vlera, shkathtësi dhe njohuri nga përvoja e përditshme. Edhe jashtë muzeve, të mësuarit informal luan një rol kryesor në procesin e formimit të qëndrimeve e besimeve të individëve e shoqërisë. Një vizitë e vetme në një muze mund t'i prezantojë vizitorët me informata më të hollësishme mbi një temë të caktuar. Mjedisi i muzeve ju lejon të krijoni përvojat tuaja unike dhe të përzgjidhni informacionin që ju intereson

## 4. Muzetë janë qendra komunitare

Muzetë janë shumë më shumë sesa thjesht ruajtës të objekteve të trashëgimisë kulturore. Muzetë janë qendra të mirëfillta komunitare ku të jepet mundësia të takosh "fqinjët" e tu, të diskutosh mendime e ideologji dhe të bëhesh pjesë aktive e komunitetit ku jeton. Ka gjithmonë një aktivitet në muzetë e qytetit tënd, hap faqen e muzeut në Facebook dhe bëhu pjesë e komunitetit!

## 5. Muzetë frymëzojnë

Muzetë frymëzojnë përmes eksperiencave që ata i dhurojnë vizitorëve, shpesh here dhe ndjekësve të tyre në rrjetet sociale. Këto eksperiencat e kujtime të krijuara në muze nuk fshihen asnjëherë. A keni dhe ju një muze që ju ka lënë mbresa e që ende e kujtoni në të? Nëse jo, jeni gjithmonë në kohë të vizitoni muzetë që ndodhen afër jush.

## 6. Muzetë sjellin ndryshim në komunitet

Studimet kanë gjetur se përfshirja e komunitetit në muze ndikon drejtpërdrejtë në zhvillimin e këtij komuniteti. Duke qenë se muzetë po konsiderohen gjithnjë e më shumë si qendra komunitare që ofrojnë qasje në ide dhe përjetime të reja, sot ato janë kthyer njëkohsisht dhe në "pika të nxeha" të ndryshimit dhe angazhimit qytetar. Edukimi i brezave përmes muzeve ndikon drejtpërdrejtë në mirëqenien e komuniteteve dhe në krijimin e një shoqërie më të angazhuar e më të vetëdijshme për detyrat e saj qytetare.

## 7. Muzetë janë vendet ideale për kalimin e kohës së lirë

Muzetë janë padyshim vendi ideal për të kaluar disa moment të bukura me miq e familjarë. Lidhjet personale mes individëve të shoqërisë mund të përforcohen përmes vizitave në muze dhe diskutimit mbi artin, kulturën dhe trashëgiminë. Prindërit apo miqtë tuaj mund të kthehen në udhërrëfyes turistikë dhe koha fluturon duke vizituar pavionet e muzeve që mbartin mijëra vite histori.

## 8. Muzetë mund të jenë dhe partner i mundshëm në biznes

Për të mbajtur hapur një muze duhen patjetër shumë mjete dhe produkte. Muzetë mund të jenë mundësia perfekte për zgjerimin e biznesit tuaj apo ofrimin e shërbimeve. Produkti apo shërbimi juaj do të reklamohet indirekt te qindra vizitorë dhe ky partneritet me muzeun mund të ishte perfekt për një imazh pozitiv të kompanisë suaj. Nëse e shihni të arsyeshme,

muzeun mund ta ktheni dhe në një biznes tuajin. Janë të shumta muzetë privatë e në disa vende të botës ato konkurojnë dhe muzetë me famë ndërkombëtare.

## 9. Muzetë kanë nevojë për mbështetjen tuaj

Janë të shumtë muzetë me qëllime jo-fitimprurëse që mision kryesor kanë edukimin dhe frymëzimin e vizitorëve dhe për të përmbushur këtë mision ato kanë gjithmonë nevojë për mbështetjen tuaj. Për fat të keq shumë qytetarë ende nuk e dinë që muzetë publikë nuk kanë qëllime fitimprurëse. Bëni një dhurim ose anëtarësohuni në muze. Në shumë mënyra, mbështetja e një muzeu nëpërmjet vizitës ose – edhe më mirë – përmes anëtarësimit ose mbështetjes filantropike – është një mënyrë për të forcuar komunitetet dhe për t'u ndihmuar muzeun të krijojë programe të efektshme që përmbushin misionin e tij.

## 10. Ka gjithmonë një muze pranë teje

Sipas Aleancës Amerikane të Muzeve, në Shtetet e Bashkuara muzetë presin për vit rreth 865 milionë vizitorë ose mesatarisht 2.5 milionë vizitorë në ditë. Muze ka në çdo shtet e në rastin e vendit tonë në çdo qark e thuajse çdo bashki. Së shpejti Rijetëzimi i Muzeve Lokalë do të publikojë dhe një listë të plotë me muzetë e vendit tonë.

**Këshillë:** Vizitoni faqet online të muzeve dhe ndiqni njoftimet mbi ditët se kur muzeu mund të vizitohet falas. Zakonisht muzeu mund të vizitohet falas gjatë të dielës së fundit të muajit, 18 Prilli – Dita Ndërkombëtare e Monumenteve, 18 Maji- Dita Ndërkombëtare e Muzeve, 29 Shtatori – Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore, Ditët e Festave Kombëtare etj. ([gazeta-Shqip.com](http://gazeta-Shqip.com))



# Bangkoku, qyteti i një mijë ngjyrave në Tajlandë

Bangkok është thelbi i Tajlandës dhe është edhe kryeqyteti i saj. Nga një port i vogël tregtar është bërë një nga qytetet më dinamike dhe me ndikim në Azinë Juglindore. Qyteti ka rreth 10 milionë banorë, dhe falë zhvillimit të tij të papritur, është një nga ato qytete që ka më shumë trafik. Në këtë qytet, për arkitekturën e tij polikromatike dhe demonët e çuditshëm të artit qëndron Pallati i Madh i Bangkok, ish-rezidenca zyrtare e sundimitarit të Tajlandës. Ai përbëhet nga njëqind ndërtesa që ju lënë pa frymë për shumëllojshmërinë e stileve arkitekturore dhe pasurisë e detajeve. Është një festë e artit dhe mozaikë, tempujt dhe kishat. Kompleksi u ndërtua në vitin 1782 me urdhër të mbretit Rama I, i cili transferoi kryeqytetin nga Thonburi në Bangkok. Heterogjeniteti i stileve varet nga fakti se ndërtesat dhe elementët dekorativë në përgjithësi janë ndërtuar në rreth një shekull, sipas dëshirës së sovranëve që arritën në fron nga Rama I e tutje. Në Wat Phra Kaew është statueta e nderuar e Budës smerald, që konsiderohet statuja më e shenjtë në të gjithë Tajlandën.

Midis manastireve më të vjetra dhe më të respektuara është Wat Pho. Ky është vendi ku ruhet Buda e famshme. Një statujë e famshme 46 metra e modeluar në suva dhe e mbuluar me një pllakë ari që përshkruan Budën në arritjen e Nirvana. Këtu ka më shumë se njëqind kontejnerë ku është e zakonshme të lihet një ofertë si simbol i fatit të

mirë. Vetëm jashtë kompleksit monumental, ka stalla të shpërndara me vepra artizanale lokale, një mozaik ngjyrash gjithmonë shumë të gjalla.

Gjatë natës, Bangkoku është edhe më i ethshëm sesa gjatë ditës. Nën një tuk-tuk tradicional të zbukuruar me dritë me ngjyra të shumta mund të shkosh në zbulimin e qytetit të madh. Bangkoku ka një hekurudhë të ngritur. Ai përbëhet nga dy linja hekurudhore që ndërpriten në një pikë të vetme për një gjatësi totale prej rreth 30 kilometrash. Kjo është mënyra më e shpejtë për të udhëtuar nga njëra anë e qytetit në tjetrën. Stacioni Siam është një pikë qendrore e qytetit, një vend takimi dhe destinacion ideal pazaresh. Në çdo cep të qytetit ka tuk-tuk. Sigurisht mjetet më praktike, jo vetëm folkloriste, me të cilat do të lëvizin në kryeqytet.

Ndër kuriozitetet që lidhen me këtë kulturë ekziston një çështje që ka të bëjë me fushën e sportit. Në fakt, në Tajlandë, ushtrohet një art luftarak të njohur si Muay Thai ose si boks tajlandez. Kjo është një teknikë e lashtë luftimi e Thai, ku kandidatët sfidojnë njëri-tjetrin, duke përdorur kombinime të lëvizjeve që përfshijnë tetë pjesë të trupit.

Një nga faktet më interesante dhe kureshtarë në lidhje me këtë pjesë të botës janë tregjet lundruese. Është pikërisht këtu, në brigjet e lumit që rrjedh jetën e vërtetë të njerëzve lokalë. Shitësit largohen herët, para agimit dhe shesin fruta, prime



dhe suvenire në anije. Një traditë që pasqyron kulturën e të gjithë Azisë Juglindore. Ndër më të njohurit është ajo e Amphaëa. Është një udhëtim i gjallë i anijeve që ofrojnë ushqim dhe prodhime artizanale. Është pikërisht këtu, jo shumë larg tregut që shtëpitë tipike të ndërtaura në stili dalin nga kanalet më të vogla.

Bangkoku shtrihet përgjatë lumit Cha Phraya. Lumi është aksi më i rëndësishëm i transportit dhe tregtisë në vend.

Lumi formohet në qendër të veriut të vendit, në bashkimin e lumenjve Ping dhe Nan duke krijuar një zonë ujëmbledhës me rëndësi të madhe. Lundrimi përgjatë këtij lumi ju lejon të shihni këtë qytet emocionues nga një perspektivë tjetër. nuk kalojnë pa u vënë re Kulla e Lumit Jug, një rrokaqiell me lartësi 258 metra ose River City Bangkok një qendër tregtare dedikuar artit dhe antikave. Nga ana tjetër, megjithatë, qyteti i kontrasteve në Bangkok,

gjithashtu tregon ndërtimet e saj tradicionale. Ashtu si Wat Arun, tempulli i agimit, me germën e tij qendrore të bërë me tulla të stukuara të zbukuruar me mijëra copë prej porcelani me ngjyra kineze. Bangkoku është një qytet me një mijë ngjyra, tradita interesante, tuk-tuk i pamatur dhe tempujt plot shenjtëri. Një kryeqytet që përmban të gjitha aspektet e Azisë Juglindore. Me pak fjalë, një qëllim pak të thuhet i pashmangshëm! (*gazeta-Shqip.com*)



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

LEEDS - DERBY

1

LYON - REIMS

1

CLERMONT FOOT - CHAMOIS NIORT

1

## Presidenti i futbollit anglez mbështet Dukën në zgjedhjet e UEFA-s

TIRANË, 11 JANAR - Presidenti i Federatës Angleze të Futbollit, Greg Clark, për herë të parë ka vizituar Shqipërinë dhe Federatën Shqiptare të Futbollit. Vizita e tij ka filluar nga zyrat e federatës ku ka vizituar fillimisht muzeun e futbollit shqiptar për të shkëmbyer disa çaste biseda me presidentin e futbollit shqiptar, Armand Duka, pa praninë e medieve. Clarku më pas ka vazhduar vizitën në "Shtëpinë e Futbollit" siç quhet ndryshe godina e ambienteve të reja të FShF-së dhe fushave sportive të kombëtares për t'u ndalur në fund tek Arena Kombëtare.



Në këtë periudhë fushate për organet drejtuese të qeverisë së futbollit evropian, presidenti Armand Duka po përpiket për ta siguruar mbështetjen maksimale për një nga tetët vendet e Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s dhe Greg Clark e ka shprehur hapur mbështetjen e tij. "Kam ardhur këtu që ta mbështes presidentin tuaj pasi po bën një punë

shumë të mirë për futbollin shqiptar në aspektin sportiv, por edhe në pjesën e investimeve ku shoh ndryshime të infrastrukturës. Erdha këtu që ta takoj, që të flas me të, të mësoj prej tij sepse unë kudo që shkoj kam diçka për të mësuar. Ne jemi gjithashtu mbështetës të tij në kandidimin e tij në UEFA sepse ai është një njeri që ka reputacion të mirë në Evropë në saje të punës që ka bërë,

për këtë arsye mendoj se është një kandidat e mirë", u shpreh presidenti i Federatës Angleze të Futbollit, Greg Clark. Asambleja zgjedhore për organet drejtues të UEFA-s do të zhvillohet më 7 shkurt në Romë ku, veç anëtarëve të komitetit, do të zgjedhet edhe presidenti i ri, e presidenti aktual Aleksandër Ceferin do të ketë një rikonfirmim në këtë post pasi nuk ka kandidat tjetër.

## Manchester Unitedi liron Mourinhon, e dëmshpërblen me 15 milionë paund

MANCHESTER, 11 JANAR

- Jose Mourinho është i lirë të kërkojë një skuadër, për ta vazhduar karrierën e tij si trajner. Manchester Unitedi i pagoi 55-vjeçarit një dëmshpërblim prej 15 milionë paundësh për shkarkimin e tij përpara përfundimit të kontratës. Trajneri Mourinho u largua nga drejtimi i "dajve të kuq" më 18 dhjetor për shkak të rezultateve të dobëta të skuadrës gjatë pjesës së parë të sezonit. Lajmi për pagesën e dëmshpërblimit të Mourinhos u publikua nga tabloidi britanik "Daily Mail", që citoi një burim pranë stafit të trajnerit portugez. Mourinho zgjati



kontratën vitin e kaluar me Manchester Unitedin deri në vitin 2020, me opsion rinovimit e saj edhe për një tjetër vit. Ditët e fundit emri i tij është lidhur me klubet e Realit të Madridit dhe Benficës, por deri në këtë çast nuk ka asgjë konkrete në lidhje me këtë çështje.

## KB Rahoveci, organizator i 'Final 8' të Kupës së Kosovës

PRISHTINË, 11 JANAR (ER) - Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) të premten ka marrë vendim që "Final 8" i Kupës së Kosovës për vitin 2019 të organizohet në Rahovec nga Klubi i Basketbollit Rahoveci. Në konkursin e hapur nga FBK-ja prej 28 dhjetorit 2018 deri më 9 janar 2019 për organizimin e "Final 8" të Kupës së Kosovës ka konkurruar KB Rahoveci, duke i plotësuar të gjitha kushtet në bazë të konkursit dhe Udhëzuesit për organizimin e "Final 8" të Kupës së Kosovës.



"Final 8" i Kupës së Kosovës do të zhvillohet prej 27 shkurtit

deri më 3 mars. Më 27 dhe 28 shkurt do të luhen ndeshjet

çerekfinale si dhe gjysmëfinale në konkurrencën e femrave, kurse më 1 mars ato gjysmëfinale të meshkujt, kurse finale të dyja konkurrencat do të zhvillohen më 3 mars. Duhet theksuar se me këtë rast KB Rahoveci do ta bëjë përrurimin e palestrës së re "Mizair Isma", në të cilën kanë filluar punimet para dhjetë vjetëve. Në kuadër të "Final 8" të Kupës së Kosovës do të organizohet edhe Kuvendi i Punës së FBK-së, si dhe FIBA SCOD Kampi për Referë, dhe Klinika për Gjyqtarët Potencialë në FIBA.

Të gjitha këto aktivitete organizohen nga FBK në bashkëpunim dhe KB Rahoveci dhe me mbikëqyrje të FIBA-s.

Detajet e tjera rreth organizimit të "Final 8" të Kupës së Kosovës do të bëhen të ditura javën e ardhshme, kur edhe pritet të nënshkruhet kontrata në mes të FBK-së dhe KB Rahoveci, me ç'rast do të organizohet edhe konferenca e parë për media.

Fituese të Kupës së Kosovës për edicionin e kaluar janë Z Mobile Prishtina te meshkujt dhe Prishtina te femrat.

## Hapet stadiumi për Inter - Sassuolo, por këtë herë jo për tifozët

ROMË, 11 JANAR - INTER - Sassuolo, e planifikuar për t'u luajtur të shtunën në mbrëmje, nuk do të luhet me stadiumin e mbyllur, ashtu siç e kishin vendosur organet e disiplinës në futbollin

italian, pasi Federata Italiane e Futbollit ka mirëpritur kërkesën e Interit për t'i hapur dyert e unazës së parë të stadiumit për fëmijët e shkollës së futbollit të klubit zikaltër dhe atyre të

shkollave sportive italiane. FIGC dhe Liga italiane e futbollit kanë miratuar hapjen e unazës së parë të "San Siro" për këtë kategori fëmijësh, të cilët do të mund ta ndjekin sfidën Inter - Sassuolo.

Pas incidenteve me sfond racist në sfidën Inter - Napoli, organet e disiplinës dënuan klubin zikaltër me zhvillimin e dy ndeshjeve pa tifozë dhe një të tretë pa praninë e grupimit ultras.



Autor: GAZMEND MORINA	TRAJNERI MË MIRË NË BOTË NË FOTO 1	SHUMË I LODHUR, I KËPUTUR	SËPATË E VOGËL PËR TË PRERË DEGË (sh.shq.)	KËNGËTARJA JONË E RE ... KOÇI	PËRSHËNDETJE ALLATURKA NË SHENJË NDERIMI TË THELLË	SHTËPIA E PLEQVE	<b>1</b>											
							<b>EPOKA E RE</b>	KOMANDANTE E NJË ANIJEJE	MËNJANIMI NGA GARA	RRJETË E TENISIT	VENDLINDJA E ODISEUT							
BRISK I VOGËL PËR RROJË (shq.)	<input type="radio"/>												SHTET NË AFRIKË (pashq.)					
BANOR I NJË SHTETI AZIATIK	<input type="radio"/>												MJET I THJESHTË PUNE					
FJALA E DHËNË PËR DIÇKA NGATËRRESË E MADHE	<input type="radio"/>												SHTRESË E HOLLË BRUMI NË TRAJTË TË RRUMBULLAKËT (shq.)					
	<input type="radio"/>			ESTONIA, LETONIA FUSHA KU ZHVILLOHET NJË PËRLESHJE (fig.)									IZET MUSA			BASHKËT. FUTBOLLISTI NË FOTO 3 (shqip.)		
VEESHJE E SIPËRME PREJ SHAJAKU SI JELEK ME MËNGË (shq.)	<input type="radio"/>												LUMË I MADH NË HUNGARI			<input type="radio"/>		
UNITED STATES	<input type="radio"/>		RAMADAN AVDIU LLOJ VEPRE MUZIKORE (sh.shq.)			ARSYE QË TË SHTYN PËR TË BËRË DIÇKA							ÇDONJËRI NGA GYPAT NËPËR TË CILËT KALON GJAKU			<input type="radio"/>	"INTER"	
BANORE E NJË SHTETI EVROPIANO-AZIATIK	<input type="radio"/>												MINDERI I ULËT (vjet.)			<input type="radio"/>		
SATIRIK	<input type="radio"/>						NJË PLANET	TOKA E BUKËS	<b>EPOKA E RE</b>	BEDRI ISLAMI	MODELJA SHQIPTARE ÇUNMULAJ	BITUMI NATYROR	REGJISORI ... HALILI KYÇ			<input type="radio"/>		
BASHKËT.	<input type="radio"/>	ANIJATA DY BASHKËTINGËLLORE							FJALA E NDERIT VEÇORI THELBËSORE E NJË DUKURIE				ILAZ KODRA MJET I THJESHTË LUNDRIMI (shq.)			<input type="radio"/>	CAK	
KËNGËTARJA RITA ...	<input type="radio"/>			LLOJ I NJË PRODHIMI SIPAS FORMËS A MADHËSISË EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN									ENI LENOKS ZANORE			<input type="radio"/>		
<b>EPOKA E RE</b>	FAZË EPOSI					DIPLOMATI NORVEGJEZ ... EIDE DEM			"IRLANDA" KËNGËTARI ... STAFJA (shq.)				ISH FUTBOLLISTI SHQIPTAR ... JUPI METËR, INDIUM			<input type="radio"/>		
ZANORE		AKTORJA SHQIPTARO-KROATE BERISHA AGIM POSHKA						SHTET I VOGËL NË AMERIKË BASHKËT.					ISMET MUNISHI ANITA KOSUMI			<input type="radio"/>		
BIMË BARISHTORE QË PËRDOREN GJERËSISHT SI USHQIM						NJOLLA FUTBOLLISTI NË FOTO 2 RONALDO						KAMPIONI ZANORE			<input type="radio"/>			
ISMET PEJA			FUTBOLLISTI ... VAN BOMEL (MILAN)					DY BASHKËTINGËLLORE ELEMENT KIMIK			EKZEMPLAR I VETËM NJË E HAPUR E NJËRËS KËMBË PARA					<input type="radio"/>		
<b>2</b>							RESHAT ARBANA	<input type="radio"/>		INDIANA, HAITI EMËR YNI DJALI (shq.)								
							I VURA NË SITË	<input type="radio"/>										
							AKTORJA E SHQUAR MERYL ... (shqip.)	<input type="radio"/>										
							TANTAL, FLUOR	<input type="radio"/>			RRJEDHË NATYRORE E MADHE DHE E PËRHERSHME UJI (shq.)	I MITURI, AXHAMIU						
							SHTET NË EVROPË (pashq.)	<input type="radio"/>										
							ZANORE	<input type="radio"/>		HIJESHI, BUKURI QË TË BËN PËR VETE ARBEN MALAJ								
							MUZIKANTI KRASNIQI (shq.)	<input type="radio"/>										
							OLIVIER MARTINEZ	<input type="radio"/>		DY ZANORE								
<b>3</b>																		

ZGJIDHJA E FJALËKRITËRIT: ZHILETA, KENI, OMANEZ, ALET, ZOTIMI, PETA, BELA, ELI, IM, K, MITANI, TISA, US, RA, ENA, RUSE, SH, NIMI, IRONIK, EMIN, NJ, NAVATA, BESA, IK, ORA, ASORTIMENT, ELI, STAD, KAL, IR, RED, E, ANITA, PANAMA, IM, PATATE, LARA, I PARI, IP, MARK, RD, UNIKAT, RA, IH, I SITA, STRIP, TAF, ITALLI, A, NUR, NAIMI, OM, IU.





# AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla  
"RITMO - L"  
Prishtinë**

**Eksperienca jonë  
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:  
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

**Tel / kontakt:**

**044 248 173**

**044 200 604**

**044 375 333**



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

